



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.122

31 korrik

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9948 datë 7.7.2008	Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore	5387
Ligj nr.9949 datë 7.7.2008	Për një ndryshim në ligjin nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	5394
Ligj nr.9950 datë 10.7.2008	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e “Marrëveshjes së TRIPS-it (aspekte të tregtisë, që lidhen me pronësinë intelektuale)”	5395
Ligj nr.9951 datë 10.7.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”	5400
Ligj nr.9952 datë 14.7.2008	Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it	5402
Ligj nr. 9953 datë 14.7.2008	Për një shtesë në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar ...	5415
Ligj nr.9954 datë 17.7.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e rrugëve dytësore dhe vendore”.	5416

LIGJ
Nr.9948, datë 7.7.2008

**PËR SHQYRTIMIN E VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË
PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë:

- a) shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore;
- b) strukturat shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, të dhënë në pronësi personave fizikë ose juridikë vendas, si dhe detyrat e përgjegjësitë e këtyre strukturave.

KREU I
KRIJIMI I TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE

Neni 2
Objekti i vlefshmërisë ligjore të tokës në pronësi

1. Kanë vlefshmëri ligjore titujt e pronësisë private mbi tokën, të krijuar te:
 - a) sipërfaqet, që më 1.8.1991 kanë figuruar në regjistrat kadastralë, në zërin “Tokë bujqësore” dhe janë përfshirë në territoret e administruara nga ish-kooperativat bujqësore deri në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar;
 - b) sipërfaqet e tjera të tokave bujqësore, të administruara nga ish-ndërmarrjet bujqësore dhe institucionet e tjera shtetërore, të kaluara për ndarje për fshatrat e ish-kooperativave bujqësore vetëm me miratim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, deri në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8337, datë 30.4.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”;
 - c) sipërfaqet e tokave bujqësore të ish-NB-ve, sipas dispozitave të përcaktuara në ligjin nr.8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”.
2. Nuk kanë vlefshmëri ligjore titujt e pronësisë në të gjitha sipërfaqet e tjera, që më 1.8.1991 nuk kanë figuruar në regjistrat kadastralë, në zërin “Tokë bujqësore”, si pyje, livadhe, kullota, tokë pyjore dhe sipërfaqe të tjera të tokës jobujqësore, pavarësisht miratimit të ndryshimeve dhe kalimeve të këtyre zërave në tokë bujqësore pas kësaj date.

Neni 3
Kriteret për vlefshmërinë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore

Subjekte të përfitimit të tokës bujqësore në pronësi dhe të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore janë personat fizikë dhe juridikë vendas. Për krijimin dhe fitimin e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore janë të vlefshme vetëm kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 255, datë 2.8.1991, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”, sipas procedurës së përcaktuar në udhëzimin nr.106, datë 23.2.1996, të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit “Për procedurat e kalimit të tokës nga përdorimi në pronësi”.

Neni 4
Procedurat dhe dokumentacioni i titullit të pronësisë

Dhënia e tokës bujqësore në pronësi realizohet dhe vërtetohet vetëm me dokumentin bazë unik, që është “akti i marrjes së tokës në pronësi”.

“Akti i marrjes së tokës në pronësi” është i vlefshëm vetëm kur ai është krijuar sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 230, datë 22.7.1991, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e komisioneve të tokave”, të ndryshuar dhe në udhëzimin nr.2, datë 2.8.1991, të Këshillit të Ministrave “Për funksionimin e komisioneve të tokës në rrethe e fshatra”.

Titujt e pronësisë për tokat bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore janë të vlefshëm vetëm kur ato janë krijuar sipas dispozitave të ligjit nr.8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore” dhe procedurave të përcaktuara në udhëzimin nr.106, datë 23.2.1996, të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit “Për procedurat e kalimit të tokës nga përdorimi në pronësi”.

KREU II

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E STRUKTURAVE SHETËRORE TË SHQYRTIMIT TË VLEFSHMËRISË LIGJORE TË DHËNIES SË TOKËS NË PRONËSI

Neni 5

Komisioni Qeveritar i Tokës (KQT)

Komisioni Qeveritar i Tokës (KQT) kryesohet nga Zëvendëskryeministri. Pranë ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe në shërbim të KQT-së krijohet dhe funksionon sekretariati teknik.

Neni 6

Detyrat dhe përgjegjësitë e KQT-së

KQT-ja ka detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë (KV), nëpërmjet:

- a) vendimeve që merren në mbledhje;
- b) akteve që përgatiten nga sekretariati i KQT-së;
- c) kontrolleve që ushtrohen nga KV-të;
- ç) marrjes së informacionit për ndarjen e tokës nga struktura të ndryshme shetërore dhe nga shtetas;

d) shqyrtimit të ankimeve për vendimet që kanë marrë KV-të.

2. Merr vendime për zgjidhjen e konflikteve territoriale ndërmjet qarqeve për kufijtë e zërit kadastral të tokës bujqësore.

3. Shqyrton ecurinë e verifikimit nga KV-të për zbatimin e akteve të nxjerra gjatë periudhës së kryerjes së reformës së tokës nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për kalimet ose ndryshimet e sipërfaqes së tokës bujqësore nga njëri qark tek tjetri, nga njëra komunë dhe/ose bashki tek tjetra, nga njëri fshat tek tjetri dhe të ndryshimeve të tjera të tokës së destinuar për ndarje.

4. Kërkon, në mbledhje ose ndërmjet dy mbledhjeve, raportime dhe informacione nga drejtuesit e KV-ve për ecurinë e verifikimit të zbatimit të dispozitave për ndarjen e tokës bujqësore dhe, në përfundim të shqyrtimit të tyre, nxjerr vendimet përkatëse.

5. KQT-ja u propozon organeve eprorë dhënien e masave disiplinore dhe administrative ndaj drejtuesve të organeve të qeverisjes vendore dhe strukturave të tjera shetërore, veprimtaria e të cilave lidhet me krijimin e titujve të pronësisë mbi tokën, për çdo rast, kur vëren moszbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

Neni 7

Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë (KV)

1. KV-ja krijohet pranë prefektit të çdo qarku dhe drejtohet nga drejtori i KV-së, nën autoritetin dhe varësinë e drejtpërdrejtë të prefektit.

2. KV-ja drejton të gjithë veprimtarinë për shqyrtimin e vlefshmërisë së krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, në juridiksionin e prefekturës, nëpërmjet:

a) shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, kërkesave, informacioneve, që i paraqiten nga shtetasit dhe strukturat shtetërore, veprimtaria e të cilave lidhet me pronësinë mbi tokën bujqësore;

b) kontrolleve të drejtpërdrejta, të ushtruara me nismën e vet, mbi veprimtarinë dhe veprimet e kryera nga ish-komisionet e tokës, të të gjitha niveleve, në procesin e ndarjes së tokës. Këto kontrolle kryhen të plota në sipërfaqen e tokave të ish-NB-ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi të turizmit, të përcaktuara sipas ligjit nr. 7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

c) vendimeve që merr në mbledhjet që thirren dhe drejtohen nga prefekti;

ç) zbatimit të detyrave dhe vendimeve të KQT-së.

Neni 8

Detyrat dhe përgjegjësitë e KV-së

KV-ja ka detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Zgjidh mosmarrëveshjet e evidentuara:

a) për kufijtë e tokës bujqësore, ndërmjet rretheve, brenda qarkut;

b) për kufijtë e tokës bujqësore, ndërmjet fshatrave (subjekteve), që kanë qenë në përbërje të së njëjtës ish-kooperativë bujqësore. Vendimi u njoftohet komunave dhe/ose bashkive, në juridiksionin e të cilave ndodhen këto fshatra;

c) ndërmjet individëve dhe ish-komisionit të tokës së fshatit.

Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve bëhet me kërkesën e palëve ose me nismën e vetë KV-së.

2. Merr vendimet përkatëse për çdo mosmarrëveshje ose konflikt, të lindur ndërmjet personave fizikë ose juridikë, për bazueshmërinë ligjore të titujve të pronësisë, të krijuar mbi tokën bujqësore.

Kur objekti i konfliktit ndërmjet palëve rezulton në zona kadastrale, ku është kryer regjistrimi i tokës, me cilësinë e pasurisë së paluajtshme dhe ky regjistrim është marrë në dorëzim nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP) ose kur në zonën kadastrale përkatëse ka përfunduar periudha 90-ditore e afishimit të rezultateve të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme, vendimi i KV-së i dërgohet për veprim ZVRPP-së së rrethit dhe për informim e evidentim seksionit të administrimit dhe mbrojtjes së tokës (SAMT) në qark.

3. Kontrollon dokumentet dhe veprimtarinë, që kanë kryer komisionet e tokës së komunave dhe/ose bashkive për zbatimin e dispozitave ligjore të ndarjes së tokës, gjatë procesit të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve dhe të konflikteve, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni dhe, në përfundim të këtij kontrolli, merr vendimet përkatëse për korrigjimet e nevojshme, shfuqizimin e plotë apo të pjesshëm të këtij dokumentacioni dhe krijimin e dokumentacionit të ri, në bazë të kritereve të përcaktuara në këtë ligj.

4. Dërgon në seksionin e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës (SAMT) të qarkut autorizimin për lëshimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi, në bazë të dokumentacionit të ri ligjor të krijuar. Procedurat e krijimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, që vijnë si pasojë e korrigjimeve të kryera, sipas dispozitave ligjore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Shqyrton drejtpërdrejt dhe merr vendime për konflikte dhe mosmarrëveshje ndërmjet palëve, kur për to është vendosur rishqyrtimi, në rrugë administrative, me vendim të formës së prerë të organeve gjyqësore. Në këtë rast, vendimi i KV-së është përfundimtar. Ankimimi kundër këtij vendimi mund të bëhet në gjykatën që ushtron veprimtarinë në juridiksionin ku ndodhet toka bujqësore, për të cilën ka lindur konflikti.

6. Urdhëron kryetarët e komunave dhe/ose bashkive të plotësojnë aktet e marrjes së tokës në pronësi, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore, në rastet kur:

a) komisioni i tokës së fshatit nuk ka plotësuar dokumentacionin ligjor të ndarjes së tokës;

b) familjet bujqësore ose individët, që faktikisht e përdorin dhe e shfrytëzojnë tokën bujqësore dhe janë subjekte ligjore të trajtimit me tokë në pronësi, sipas përcaktimit të nenit 3 të këtij ligji, por që nuk janë pajisur me dokumente pronësie dhe që për këtë sipërfaqe nuk janë lëshuar akte të marrjes

së tokës në pronësi për persona të tjerë.

Dokumentacioni i plotësuar dorëzohet në KV dhe pas verifikimit i kalohet SAMT-it të qarkut.

Për çdo rast të mospranimit të marrjes së këtij dokumentacioni nga familjet bujqësore ose individët, mbahet procesverbal për refuzim toke.

Familjet bujqësore që refuzojnë të pajisjen me aktin e marrjes së tokës në pronësi, sipas këtij ligji dhe që faktikisht e përdorin dhe e shfrytëzojnë atë, u nënshtrohen sanksioneve të parashikuara në kreun III të këtij ligji.

7. Kërkon nga kryetarët e komunave dhe/ose të bashkive, në cilësinë e ish-kryetarëve të komisioneve të tokës, nga ish-kryetarët e komisioneve të tokës në fshatra, nga SAMT-et, në këshillin e qarkut, ZVRPP-të e rrethit dhe zyra rajonale e AKKP-së dokumente dhe informacione për veprimtarinë e veprimet e kryera gjatë të gjithë periudhës së ndarjes së tokës.

8. Raporton, në mënyrë periodike, para KQT-së për përmbushjen e detyrimeve, të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 9

Vendime të KV-së për tituj pronësie të kundërligjshme

1. Kur gjatë verifikimit të dokumentacionit konstatohet se titulli i pronësisë mbi tokën bujqësore është lëshuar në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në nenet 2, 3 dhe 4 të kreut I të këtij ligji dhe mbajtësi i titullit të pronësisë e posedon dhe e shfrytëzon tokën bujqësore faktikisht, KV-ja merr vendim:

a) për pavlefshmërinë ligjore të titullit të pronësisë, kur “akti i marrjes së tokës në pronësi” është lëshuar mbi:

i) tokat bujqësore të ish-NB-ve, të cilat përjashtohen për kalim në pronësi nga dispozitat e ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”;

ii) tokat bujqësore të ish-kooperativave bujqësore, që shtrihen në zonën e zhvillimit me përparësi të turizmit, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe sipërfaqe të tjera të tokës bujqësore, që me vendime të organeve kompetente kanë kaluar në zërin kadastral “Tokë urbane” (truall) dhe përfshihen brenda vijave kufizuese të qendrave të banuara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji;

iii) çdo sipërfaqe të përcaktuar në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji;

iv) çdo sipërfaqe toke, për të cilën Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës (AKKP) dhe zyrat rajonale të saj u kanë konfirmuar njohjen e pronësisë dhe të drejtën e kompensimit fizik subjekteve të shpronësuar;

v) çdo sipërfaqe toke, në të cilën preken interesa të ligjshëm të personave të tretë dhe/ose ekzistojnë konflikte mbi të;

b) për ofrimin e mbajtjes së titullit të pronësisë mbi tokën dhe ligjërimin e tij, për një sipërfaqe toke deri në 10 për qind mbi normën e tokës për frymë të fshatit. Përjashtohen sipërfaqet e tokave bujqësore të përcaktuara në shkronjën ”a” të pikës 1 të këtij neni.

Ligjërimi i titullit të pronësisë bëhet kundrejt detyrimit për të paguar masën e plotë të vlerës, të llogaritur me çmimet, sipas hartës së vlerës së tokës të AKKP-së, bazuar në metodikën për vlerësimin e pronës së paluajtshme, miratuar me vendim të Kuvendit. Në këtë rast KV-ja merr vendim për pajisjen e tij me dokumentacion të ri ligjor. Vendimi i dërgohet SAMT-it në qark brenda 10 ditëve, i cili përpilon aktin e marrjes së tokës në pronësi brenda 30 ditëve nga dita e mbërritjes të këtij vendimi.

2. Kur mbajtësi i titullit të pronësisë, të krijuar në mënyrë të kundërligjshme, refuzon ligjërimin e këtij titulli, sipas shkronjës ”b” të pikës 1 të këtij neni, brenda 30 ditëve KV-ja merr vendim për pavlefshmërinë e titullit të pronësisë. Kundër personit që vazhdon mbajtjen dhe shfrytëzimin e tokës bujqësore forcërisht zbatohen sanksionet e parashikuara në kreun III të këtij ligji.

3. Kur mbajtësi i parë i titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore, të lëshuar në kundërshtim me ligjin, nuk e posedon më tokën në mënyrë të plotë ose të pjesshme, si pasojë e transaksionit të realizuar ose të shpronësimit për interes publik të kryer, detyrohet që për sipërfaqen përkatëse të tokës së shitur ose të shpronësuar të kryejë pagesën e kësaj toke, vlera e të cilës llogaritet me çmimet, sipas hartës së vlerës së tokës të AKKP-së, bazuar në metodikën për vlerësimin e pronës së paluajtshme, miratuar me vendim të Kuvendit.

Vendimi i KV-së merret pasi të jetë vënë në dijeni mbajtësi i parë i titullit të pronësisë së kundërligjshme dhe i komunikohet atij brenda 10 ditëve. Vendimi, përveç deklarimit të pavlefshmërisë, përmban edhe detyrimin e pagesës së vlerës së tokës. Detyrimi i shlyerjes së vlerës së tokës është titull ekzekutiv.

4. Mënyra dhe afatet e shlyerjes së detyrimit për vlerën e tokës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Procedurat për titujt e pronësisë, të krijuar në kundërshtim me ligjin

1. Kur KV-ja, gjatë verifikimit të dokumentacionit dhe të vendimeve përkatëse të komisioneve të tokës, vëren se krijimi i titullit të pronësisë mbi tokën është dhënë në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në nenet 2, 3 e 4 të këtij ligji dhe me vendimet e tij, të marra sipas neneve 8 pikat 2 e 3 dhe 9 pika 2 të këtij ligji, i paraqet gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës një kërkesë për anulimin e aktit administrativ, “akt i marrjes së tokës në pronësi”.

2. Kërkesa i paraqitet subjektit përkatës nga prefekti i qarkut brenda 7 ditëve nga data e njoftimit të vendimit për paligjshmërinë e aktit të pronësisë mbi tokën bujqësore. Objekt i kërkesës së prefektit është deklarimi i pavlefshmërisë së “aktit të marrjes së tokës në pronësi”, shfuqizimi i tij dhe kthimi i pronës në pronësi të shtetit.

3. Gjykata shqyrton kërkesën e prefektit brenda 60 ditëve, duke thirrur në proces gjyqësor edhe Avokatin e Shtetit.

Neni 11

Përbërja, mënyra e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësive të KQT-së, të sekretariatit teknik dhe KV-së, përveç sa përcaktohen në këtë ligj, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III SANKSIONET

Neni 12

Ndalimi i pushtimit (zënies) të tokës

1. Organet e qeverisjes vendore dhe strukturat pranë tyre, brenda juridiksionit, ndalojnë çdo zënie dhe përdorim të tokës, në kundërshtim me këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

2. Në rastet e pushtimit nga persona fizikë apo juridikë:

a) të tokës bujqësore, në pronësi të shtetit (toka të pandara dhe disponibël shtetërore), detyrimin e bërjes së denoncimit e kanë zyrat e menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës (ZMMT) në komunë dhe/ose bashki, kryetari i fshatit, kryetari i komunës dhe/ose bashkisë, SAMT-i i qarkut dhe zyra rajonale e AKKP-së për tokën bujqësore, të kaluar në fondin fizik, për kthimin dhe kompensimin e pronës;

b) të tokës bujqësore, dhënë në pronësi ose në përdorim personave fizikë dhe juridikë, që e zotërojnë, sipas ligjit, aktin përkatës të marrjes së tokës në pronësi ose përdorim, të drejtën e denoncimit e kanë vetë pronarët ose përdoruesit e tokës bujqësore.

3. Denoncimi bëhet me shkrim dhe dorëzohet në KV.

KV-ja, brenda 15 ditëve nga marrja e denoncimit, detyrohet të mblidhet dhe të vendosë për:

a) lirimin dhe kthimin e tokës në gjendjen e mëparshme brenda 5 ditëve;

b) dënimin e kundërvajtësit me gjobë 100 lekë/m².

Vendimi i KV-së përbën titull ekzekutiv.

4. Kur kundërvajtësi nuk e zbaton në afatin e caktuar vendimin, KV-ja njofton zyrën e përmbartimit të gjykatës, në juridiksionin e së cilës ndodhet toka, për ekzekutimin e këtij vendimi.

Kur kundërvajtësi banon në një juridiksion gjyqësor të një rrethi tjetër, për ekzekutimin e vendimit ngarkohet organi i rrethit ku banon kundërvajtësi.

5. Zyra e përmbartimit të gjykatës përkatëse detyrohet të ekzekutojë vendimin e KV-së brenda

15 ditëve, duke filluar nga data e marrjes së njoftimit.

6. Organet e Policisë së Shtetit të juridiksionit përkatës detyrohen të bashkëpunojnë me organet e përbarimit, për ekzekutimin e vendimit të KV-së.

Neni 13

Kundërvajtjet administrative

1. Sipas këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

a) dhënia e titujve të pronësisë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji;

b) dhënia e titullit të pronësisë për sipërfaqe që më 1.8.1991 nuk figurojnë në regjistrat kadastralë, në zërin “Tokë bujqësore”, sipas përcaktimit të nenit 2 të këtij ligji;

c) mosdorëzimi i dokumentacionit të ndarjes së tokës në SAMT-in (Zyrën e kadastrës) e qarkut, përcaktuar në pikën 2 të nenit 17 të këtij ligji;

ç) mosveprimi në përmbushje të detyrimeve, të përcaktuara në pikën 7 të nenit 8 dhe në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji.

2. KV-ja vendos gjobë nga 5 000 deri në 50 000 mijë lekë për kundërvajtjet administrative, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni:

a) kundër personave fizikë ose juridikë dhe strukturave shtetërore, të ngarkuara me ligj për ndarjen e tokës, që janë shkaktare të kundërvajtjeve administrative, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni;

b) ndaj të gjitha subjekteve të përcaktuara në pikën 7 të nenit 8 dhe në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji, sipas shkronjës “ç” të pikës 1 të këtij neni.

Vendimi për kundërvajtjen administrative dhe vendosjen e gjobës nënshkruhet nga drejtori i KV-së.

Neni 14

Ankimi

Kundërvajtësi, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit për vendosjen e gjobës nga drejtori i KV-së, mund të bëjë ankim me shkrim te prefekti, i cili shqyrton ankimin dhe brenda 10 ditëve njofton subjektin ankues.

Kundër vendimit të prefektit, subjekti ankues mund t’i drejtohet brenda 30 ditëve gjykatës së rrethit gjyqësor të qarkut.

Ekzekutimi i vendimeve kryhet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar.

Neni 15

KV-të kanë të drejtë:

1. Të bëjnë kallëzim penal në organet e drejtësisë për shpërdorim të detyrës dhe shpërdorim të tokës, që ka sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit ose të shtetasve, kundër personave fizikë ose juridikë dhe strukturave shtetërore, që kanë kryer ndarjen e tokës, kur vërejnë:

a) dhënien e titujve të pronësisë (“aktit të marrjes së tokës në pronësi”) mbi sipërfaqe të tjera, që nuk janë objekt i veprimit të këtij ligji, përcaktuar në nenin 2 të tij;

b) dhënien e titujve të pronësisë (“aktit të marrjes së tokës në pronësi”) personave, që nuk përmbushin kriteret e trajtimit me tokë ose janë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga ky ligj;

c) vërtetime dhe deklarata, me informacione të pasakta, të rreme ose të falsifikuara për pajisjen ose jo me tokë bujqësore për persona fizikë ose juridikë.

2. Të bëjnë kallëzim penal në organet e drejtësisë kundër personave fizikë ose juridikë, që kanë pushtuar, në çfarëdo mënyre, tokën bujqësore në pronësi të personave të tjerë ose në pronësi shtetërore dhe kanë penguar ekzekutimin e vendimeve, titull ekzekutiv, të formës së prerë të KV-së,

përcaktuar në nenin 12 të këtij ligji.

KREU IV DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 16

Ngarkohet Këshilli i Ministrave:

1. Të nxjerrë akte nënligjore në zbatim të neneve 8, 9 e 11 të këtij ligji.
2. Të planifikojë financimin vjetor, si zë të veçantë, të shpenzimeve për prefekturat, Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe strukturat shtetërore të krijuara me këtë ligj.

Neni 17

1. Procedura e ndarjes së tokës bujqësore në pronësi, sipas dispozitave të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar, rindarja e tokës sipas nenit 5 të ligjit nr.8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, si dhe krijimi i titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore përfundojnë në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 8 të këtij ligji.

2. Në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, komisionet e tokës, të krijuara në bazë të nenit 7 të ligjit nr. 7501 “Për tokën”, të ndryshuar, mbarojnë funksionimin dhe veprimtarinë e tyre për ndarjen e tokës.

Këto komisione e dorëzojnë të gjithë dokumentacionin ekzistues të ndarjes së tokës në SAMT-in në qark.

3. Të gjitha ankesat dhe kërkesat me shkrim të personave fizikë dhe juridikë, që janë bërë dhe regjistruar pranë komisioneve të tokës së komunave dhe/ose bashkive dhe komisioneve të tokës së këshillave të qarqeve, për të cilat nuk janë përfunduar procedurat e shqyrtimit dhe të marrjes së vendimeve përkatëse, i kalojnë KV-së me procesverbal brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 18

Verifikimi i titujve të pronësisë, sipas dispozitave të këtij ligji, të përfundojë brenda 3 vjetëve nga data e hyrjes së tij në fuqi.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5826, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ Nr.9949, datë 7.7.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9655, DATË 11.12.2006 “PËR AKADEMINË E SHKENCAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6

Përzgjedhja e anëtarëve

Anëtarët e rregullt të Akademisë zgjidhen nga radhët e shkencëtarëve të shquar me titull “Profesor”, që kanë ose kanë pasur shtetësi shqiptare, të cilët, nëpërmjet punimeve origjinale, veprave përgjithësuese, me një nivel të lartë shkencor, kanë zgjidhur, teorikisht dhe praktikisht, probleme të një rëndësie të veçantë në fushën e shkencës, të ekonomisë, artit dhe kulturës, si dhe kanë dhënë ndihmesë në formimin universitar e pasuniversitar të shkencëtarëve të rinj. Anëtarë të rregullt të Akademisë zgjidhen edhe nga radhët e shkencëtarëve të shquar shqiptarë, që nuk e kanë fituar titullin “Profesor” në Shqipëri, por kanë gradën shkencore “PhD” ose “Doktor”, që punojnë aktualisht pranë universiteteve dhe qendrave kërkimore jashtë vendit dhe kanë kontribute akademike, që tejkalojnë parashikimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi për kërkimin e titullit “Profesor”.

Në raste të veçanta, anëtarë të rregullt të Akademisë mund të zgjidhen edhe personalitete me merita të shquara në fusha të ndryshme të krijimtarisë.

Anëtarë të përhershëm të Akademisë zgjidhen akademikët që kanë mbushur moshën 75 vjeç dhe kanë një kontribut të shquar, të vlerësuar gjerësisht, në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Anëtarët e asociuar të Akademisë zgjidhen nga radhët e shkencëtarëve me titull “Profesor”, që kanë ose kanë pasur shtetësi shqiptare, të cilët, nëpërmjet punimeve dhe veprave shkencore, kanë dhënë ndihmesë të rëndësishme në zhvillimin e shkencës dhe formimin universitar e pasuniversitar të shkencëtarëve të rinj. Anëtarë të asociuar të Akademisë zgjidhen edhe nga radhët e shkencëtarëve shqiptarë, që nuk e kanë fituar titullin “Profesor” në Shqipëri, por kanë gradën shkencore “PhD” ose “Doktor”, që punojnë aktualisht pranë universiteteve e qendrave kërkimore jashtë vendit dhe kanë kontribute akademike, që tejkalojnë parashikimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi për kërkimin e titullit “Profesor”.

Anëtarët e nderit zgjidhen nga radhët e personaliteteve të njohura të vendeve të tjera, të cilët kanë dhënë kontribut të shquar në zhvillimin e vendit tonë.

Personat, që kanë funksione të larta administrative dhe politike, nuk mund të kandidojnë për t’u zgjedhur anëtarë të rregullt dhe të asociuar të Akademisë gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve.

Procedurat për zgjedhjen e anëtarëve përcaktohen në statutin e Akademisë.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5827, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ

Nr.9950, datë 10.7.2008

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË NDRYSHIMET E
“MARRËVESHJES SË TRIPS-IT (ASPEKTE TË TREGTISË, QË LIDHEN ME PRONËSINË
INTELEKTUALE)”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në ndryshimet e “Marrëveshjes së TRIPS-it (Aspekte të tregtisë, që lidhen me pronësinë intelektuale)”, bërë në Gjenevë më 6 dhjetor 2005.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.5828, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Organizata Botërore
e Tregtisë

WT/L/641 8 dhjetor 2005 (05-5842)

NDRYSHIMET E MARRËVESHJES SË TRIPS-IT
VENDIM I DATËS 6 DHJETOR 2005

Këshilli i Përgjithshëm,

duke pasur parasysh paragrafin 1 të nenit X të Marrëveshjes së Marrakeshit, e cila themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë (Marrëveshja për OBT-në);

duke ushtruar funksionet e Konferencës Ministrore në intervalin ndërmjet mbledhjeve në përputhje me paragrafin 2 të nenit IV të Marrëveshjes së OBT-së;

duke pasur parasysh Marrëveshjen e TRIPS-it dhe Shëndetit Publik (WT/MIN(01)/DEC/2) dhe veçanërisht udhëzimin e Konferencës Ministrore drejtuar Këshillit për TRIPS-in që është në paragrafin 6 të deklaratës për të gjetur një zgjidhje të shpejtë për problemin e vështirësive që vendet anëtare me kapacitete të pamjaftueshme ose pa kapacitete në sektorin farmaceutik mund të hasin në përdorimin efektiv të licencimit të detyruar sipas Marrëveshjes së TRIPS-it;

duke njohur, nëse vendet anëtare të përshtatshme importuese kërkojnë të marrin furnizime sipas sistemit të parashikuar në ndryshimin e propozuar të Marrëveshjes së TRIPS-it, rëndësinë e një reagimi të shpejtë ndaj nevojave në pajtim me dispozitat e amendamentit të propozuar të Marrëveshjes së TRIPS-it;

duke iu kthyer paragrafit 11 të vendimit të Këshillit të Përgjithshëm të datës 30 gusht 2003 mbi zbatimin e paragrafit 6 të Deklaratës së Doha-s mbi marrëveshjen e TRIPS-it dhe Shëndetit Publik;

duke pasur parasysh propozimin për ndryshimin e marrëveshjes së TRIPS-it të paraqitur nga Këshilli për TRIPS-in (IP/C/41);

duke pasur parasysh konsensusin për të paraqitur ndryshimin e propozuar të vendeve anëtare për pranim;

vendosi si më poshtë:

1. Protokolli që ndryshon Marrëveshjen e TRIPS-it, bashkëngjitur këtij vendimi, miratohet dhe u paraqitet vendeve anëtare për pranim.

2. Protokolli është i hapur për pranim nga vendet anëtare deri në 1 dhjetor të vitit 2007 ose në një datë të mëvonshme që mund të vendoset nga Konferenca Ministrore.

3. Protokolli hyn në fuqi në pajtim me dispozitat e paragrafit 3 të nenit X të Marrëveshjes së OBT-së.

SHTOJCË

PROTOKOLLI QË NDRYSHON MARRËVESHJEN E TRIPS-it

Vendet anëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë,

duke pasur parasysh vendimin e Këshillit të Përgjithshëm në dokumentin WT/L/641, të miratuar në përputhje me paragrafin 1 të nenit X të Marrëveshjes së Marrakeshit, e cila themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë (Marrëveshja për OBT-në),

bien dakord si më poshtë:

1. Marrëveshja për aspektet e të drejtave të pronësisë intelektuale që lidhen me tregtinë (Marrëveshja TRIPS) me hyrjen në fuqi të protokollit në përputhje me paragrafin 4, ndryshohet sipas parashikimit në aneksin e këtij protokolli, duke shtuar nenin 31bis pas nenit 31 dhe duke shtuar aneksin të Marrëveshjes e TRIPS-it pas nenit 73.

2. Asnjë përjashtim nuk mund të bëhet në lidhje me ndonjërin nga dispozitat e këtij protokolli, pa pëlqimin e vendeve anëtare të tjera.

3. Protokolli është i hapur për pranim nga vendet anëtare deri më 1 dhjetor 2007 ose në një datë të mëvonshme që mund të vendoset nga Konferenca Ministrore.

4. Ky protokoll hyn në fuqi në përputhje me paragrafin 3 të nenit X të Marrëveshjes së OBT-së.

5. Ky protokoll depozitohet te drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Botërore të Tregtisë që i jep menjëherë secilit vend anëtar një kopje të vërtetuar të tij dhe një njoftim për pranimin e tij në përputhje me paragrafin 3.

6. Ky protokoll regjistrohet në përputhje me dispozitat e nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Bërë në Gjenevë, ditën e gjashtë të dhjetorit të vitit dy mijë e pesë, në një kopje të vetme në anglisht, frëngjisht dhe spanjisht, ku secili tekst është autentik.

ANEKSI I PROTOKOLLIT QË NDRYSHON MARRËVESHJEN E TRIPS-IT

Neni 31bis

1. Detyrimet e një vendi anëtar eksportues, sipas nenit 31(f) nuk zbatohen në lidhje me dhënien prej tij të një licence të detyrueshme në masën e nevojshme për qëllimin e prodhimit të një (disa) produkti(eve) farmaceutik(e) dhe eksportin e tij të një (disa) vend(eve) anëtar(e) i përshtatshëm importi në përputhje me termat e parashikuar në paragrafin 2 të aneksit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse një licencë e detyruar jepet nga një vend anëtar eksportues, sipas sistemit të parashikuar në këtë nen dhe në aneksin e kësaj Marrëveshjeje, një shpërblim i përshtatshëm paguhet në përputhje me nenin 31(h) në atë vend anëtar, duke pasur parasysh vlerën ekonomike të përdorimit për vendin anëtar importues, që është autorizuar në vendin anëtar eksportues. Nëse jepet një licencë për të njëjtat produkte në një vend anëtar importues të përshtatshëm, detyrimi i atij vendi anëtar sipas nenit 31(h) nuk zbatohet në lidhje me ato produkte për të cilët shpërblimi sipas fjalisë së parë të këtij paragrafi paguhet në vendin anëtar eksportues.

3. Me qëllim që të kontrollohen proceset e prodhimit për forcimin e fuqisë blerëse për të lehtësuar prodhimin lokal të produkteve farmaceutike: nëse një vend anëtar i OBT-së, vend në zhvillim ose më pak i zhvilluar, është palë në një marrëveshje tregtare rajonale brenda kuptimit të nenit XXIV të GATT 1994 dhe të vendimit të datës 28 nëntor të vitit 1979 mbi trajtimin e diferencuar dhe më të favorshëm reciprok dhe pjesëmarrjen më të plotë të vendeve në zhvillim (L/4903), të paktën gjysma e anëtarësisë aktuale, e cila përbëhet nga vendet tashmë në listën e Kombeve të Bashkuara të vendeve më pak të zhvilluara, detyrimi i atij vendi anëtar, sipas nenit 31(f) nuk zbatohet në masën e nevojshme për t'i dhënë mundësi produktit farmaceutik të prodhuar ose importuar në bazë të një licence të detyrueshme tek ai vend anëtar për t'u eksportuar në tregjet e atyre vendeve të tjera në zhvillim ose më pak të zhvilluara, palë në marrëveshjen tregtare rajonale që ndajnë problemin në fjalë të shëndetësisë. Kuptohet që kjo nuk do të cenojë natyrën territoriale të të drejtave të patentave në fjalë.

4. Vendet anëtare nuk kundërshtojnë asnjë masë të marrë në përputhje me dispozitat e këtij neni dhe aneksit të kësaj Marrëveshjeje sipas nënparagrafëve 1(b) dhe 1(c) të nenit XXIII të GATT 1994.

5. Ky nen dhe aneksi i kësaj Marrëveshjeje nuk cenon të drejtat, detyrimet dhe fleksibilitetin që vendet anëtare kanë në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje të ndryshme nga paragrafët (f) dhe (h) të nenit 31, duke përfshirë ato të riafirmuara nga deklarata e Marrëveshjes së TRIPS-it dhe Shëndetit Publik (WT/MIN(01)/DEC/2), si dhe për interpretimin e tyre. Ato nuk cenojnë masën në të cilën produktet farmaceutike të prodhuara sipas një licence të detyruar mund të eksportohen sipas dispozitave të nenit 31 (f).

ANEKSI I MARRËVESHJES SË TRIPS-it

1. Për qëllimet e nenit 31bis dhe të këtij aneksi:

a) “Produkt farmaceutik” është një produkt i licencuar ose produkt i prodhuar nëpërmjet një procesi të palicencuar, të një sektori farmaceutik të nevojshëm për të trajtuar problemet shëndetësore të publikut të njohura nga paragrafi 1 i deklaratës mbi Marrëveshjen e TRIPS-it dhe Shëndetit Publik (WT/MIN(01)/DEC/2). Kuptohet që përbërësit aktivë të nevojshëm për prodhimin e tij dhe seti diagnostikues i nevojshëm për përdorimin e tij do të përfshihen¹;

b) “Vend anëtar i përshtatshëm për import” është çdo vend anëtar më pak i zhvilluar dhe çdo vend anëtar që ka bërë një njoftim² te Këshilli i TRIPS-it në lidhje me synimin e tij për të përdorur sistemin e parashikuar në nenin 31bis dhe këtë aneks (“sistemi”) si një importues, ku kuptohet që një vend anëtar mund të njoftojë në çdo kohë që ai do ta përdorë plotësisht sistemin në mënyrë të kufizuar, për shembull vetëm në rastin e një emergjence kombëtare ose në rrethana të tjera me urgjencë ekstreme ose në rastet e përdorimit publik jotregtar. Vihet re që disa vende anëtare nuk do ta përdorin sistemin si vende anëtare importuese dhe që disa vende anëtare³ të tjera kanë deklaruar që, nëse ata e përdorin sistemin, kjo nuk ka për të qenë përveçse në situata të emergjencës kombëtare ose rrethana të tjera të urgjencës ekstreme.

c) “Vend anëtar eksportues” është një vend anëtar që përdor sistemin për të prodhuar produkte farmaceutike për, dhe eksportuar ato, në një vend anëtar të përshtatshëm importues.

2. Termat e përmendur në paragrafin 1 të nenit 31bis janë që:

a) Vendi(et) anëtar (re)⁴ i përshtatshëm importues i ka(ne) bërë një njoftim² Këshillit për TRIPS, që:

i) Përcakton emrat dhe sasitë e pritshme të produktit(eve) të nevojshëm(e)⁵;

ii) Konfirmon që vendi anëtar i përshtatshëm importues në fjalë, i ndryshëm nga një vend anëtar më pak i zhvilluar, ka konstatuar që ai nuk ka ose ka kapacitete të pamjaftueshme në sektorin farmaceutik për produktin(et) në fjalë në një prej mënyrave të parashikuara në shtojcën e këtij aneksi; dhe

iii) Konfirmon që, nëse produkti farmaceutik është licencuar në territorin e tij, ai ka dhënë ose synon t'i japë licencë të detyrues, në përputhje me nenet 31 dhe 31bis të kësaj Marrëveshjeje dhe dispozitave të këtij aneksi⁶.

b) Licenca e detyrues, e lëshuar nga vendi anëtar eksportues sipas sistemit, përmban kushtet e mëposhtme:

i) Vetëm sasia e nevojshme për të përmbushur nevojat e vendit(ve) anëtar(e) të përshtatshëm importues mund të prodhohet në bazë të licencës dhe tërësia e këtij prodhimi do të eksportohet te vendi(et) anëtar(e) që ka(ne) njoftuar nevojat e saj (tyre) te Këshilli për TRIPS-in;

ii) Produktet e prodhuara në bazë të licencës identifikohen qartë si të prodhuara sipas sistemit nëpërmjet etiketimit ose shënjitimit specifik. Furnitorët duhet t'i dallojnë këto produkte nëpërmjet paketimit të veçantë dhe/ose ngjyrës/formës së vetë produkteve, me kusht që ky dallim të jetë praktik dhe të mos ketë ndikim të madh në çmim;

iii) Para fillimit të dërgimit, subjekti i licencuar shpall në faqen e internetit⁷ informacionin e

¹ Ky nënparagraf nuk cenon nënparagrafin 1(b).

² Kuptohet që ky njoftim nuk është i nevojshëm për t'u aprovuar nga një organ i OBT-së për të përdorur sistemin.

³ Australia, Kanadaja, Komunitetet Europiane, për qëllimet e nenit 31bis dhe këtij aneksi, me shtetet e tij anëtare, Islanda, Japonia, Zelanda e Re, Norvegjia, Zvicra dhe Shtetet e Bashkuara.

⁴ Njoftimet e përbashkëta që japin informacionin e kërkuar sipas këtij nënparagrafi mund të bëhen nga organizatat rajonale të përmendura në paragrafin 3 të nenit 31bis në emër të anëtarëve të përshtatshëm importues që përdorin sistemin dhe që janë palë në to, me pëlqimin e atyre palëve.

⁵ Njoftimi ofrohet publikisht nga Sekretariati i OBT-së në një faqe në websit-in e OBT-së dedikuar sistemit.

⁶ Ky nënparagraf nuk cenon nenin 66.1 të kësaj Marrëveshjeje.

⁷ Subjekti i licencuar mund të përdorë për këtë qëllim websit-in e vet ose, me ndihmën e Sekretariatit të OBT-së, faqen në websit-in e OBT-së të dedikuar sistemit.

mëposhtëm:

- Sasitë që dorëzohen tek çdo destinacion sipas parashikimit të pikës (i) më sipër; dhe

- Tiparet dalluese të produktit(eve) të parashikuar në pikën (ii) më sipër.

c) Vendi anëtar eksportues njofton⁸ Këshillin për TRIPS-in në lidhje me dhënien e licencës, duke përfshirë kushtet, bashkëngjitur asaj⁹. Informacioni i dhënë përfshin emrin dhe adresën e të licencuarit, produktin(et) për të cilat licenca është dhënë, sasinë(të) për të cilat ajo është dhënë, vendin(et) tek të cilat produkti(et) duhet të dërgohet dhe kohëzgjatjen e licencës. Njoftimi tregon gjithashtu dhe adresën e faqes së internetit të përmendur në nënparagrafin (b)(iii) më sipër.

3. Për të siguruar që produktet e importuara sipas sistemit të përdoren për qëllime të shëndetit të publikut për të cilat janë importuar, vendet anëtare importuese të përshtatshme marrin masat e arsyeshme brenda mundësive të tyre, proporcionalisht me kapacitetet e tyre administrative dhe me riskun e diversionit tregtar për të parandaluar rieksporimin e produkteve që janë importuar në territoret e tyre sipas sistemit. Në rast se një vend anëtar importues i përshtatshëm që është një vend anëtar në zhvillim ose më pak i zhvilluar, has vështirësi në zbatimin e kësaj dispozite, vendet anëtare të zhvilluara, me kërkesë dhe sipas kushteve dhe termave të rëna dakord bashkërisht, do të sigurojnë bashkëpunim teknik dhe financiar me qëllim që të lehtësohet zbatimi i saj.

4. Vendet anëtare do të sigurojnë mundësinë e përdorimit të mjeteve ligjore për të parandaluar importin dhe shitjen në territoret e tyre të produkteve të prodhuara sipas sistemit dhe që janë shmangur në tregjet e tyre në kundërshtim me dispozitat e tij, duke përdorur mjetet e kërkuara për të qenë në dispozicion në bazë të kësaj Marrëveshjeje. Nëse një vend anëtar konsideron që këto masa duken të pamjaftueshme për këtë qëllim, çështja mund të rishikohet nga Këshilli i TRIPS-it me kërkesë të atij vendi anëtar.

5. Me qëllim kontrollin e proceseve të prodhimit për qëllimet e forcimit të fuqisë blerëse dhe lehtësimin e prodhimit lokal të produkteve farmaceutike, njihet që duhet të nxitet zhvillimi i sistemeve që parashikojnë dhënien e licencave rajonale për t'u zbatuar në vendet anëtare, të përshkruara në paragrafin 3 të nenit 31bis. Për këtë qëllim, vendet anëtare të zhvilluara, marrin përsipër të sigurojnë bashkëpunim teknik në përputhje me nenin 67 të kësaj Marrëveshjeje, duke bashkëpunuar me organizata të tjera përkatëse ndërkombëtare.

6. Vendet anëtare njohin dëshirën e nxitjes së transferimit të teknologjisë dhe ndërtimit të kapaciteteve në sektorin farmaceutik me qëllim që të tejkalohen problemet e hasura nga vendet anëtare me ose pa kapacitete prodhuese të mjaftueshme në sektorin farmaceutik. Për këtë qëllim, vendet anëtare importuese të përshtatshme dhe vendet anëtare eksportuese inkurajohen të përdorin sistemin në atë mënyrë që të nxiste këtë objektiv. Vendet anëtare marrin përsipër të bashkëpunojnë për t'i treguar vëmendje të veçantë transferimit të teknologjisë dhe ndërtimit të kapaciteteve në sektorin farmaceutik në punën që duhet të ndërmerret në përputhje me nenin 66.2 të kësaj Marrëveshjeje, paragrafin 7 të deklaratës mbi Marrëveshjen e TRIPS-it dhe Shëndetit Publik dhe çdo punë tjetër të Këshillit për TRIPS-in.

7. Këshilli për TRIPS-in rishikon çdo vit funksionimin e sistemit me qëllim sigurimin e veprimit të tij efektiv dhe raporton çdo vit në lidhje me funksionimin e tij para Këshillit të Përgjithshëm.

⁸ Kuptohet që ky njoftim nuk është i nevojshëm për t'u aprovuar nga një organ i OBT-së për të përdorur sistemin.

⁹ Njoftimi ofrohet publikisht nga Sekretariati i OBT-së në një faqe në websit-in e OBT-së dedikuar sistemit.

**SHTOJCË PËR ANEKSIN E MARRËVESHJES SË TRIPS-IT
VLERËSIMI I KAPACITETEVE PRODHUESE NË SEKTORIN FARMACEUTIK**

Vendet anëtare më pak të zhvilluara, mendohet të kenë ose të mos kenë kapacitete të pamjaftueshme në sektorin farmaceutik.

Për vende të tjera anëtare importuese, të përshtatshme mungesa ose pamjaftueshmëria e kapaciteteve prodhuese për produktin(et) në fjalë mund të përcaktohet në një nga mënyrat e mëposhtme:

- i) Vendi anëtar në fjalë ka konstatuar që nuk ka kapacitete prodhuese në sektorin farmaceutik; ose
- ii) nëse vendi anëtar ka një kapacitet të caktuar prodhues në këtë sektor, ai e ka shqyrtuar këtë kapacitet dhe ka konstatuar që, duke përfshirë ndonjë kapacitet të zotëruar ose kontrolluar nga pronari i licencës, është tashmë e pamjaftueshme për qëllimet e përmbushjes së nevojave të tij. Nëse konstatohet se ky kapacitet është bërë i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e vendit anëtar, sistemi nuk vazhdon të zbatohet.

LIGJ

Nr.9951, datë 10.7.2008

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.9270, DATË 29.7.2004 “PËR
SISTEMIN E ADRESAVE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e krijimit dhe të administrimit të sistemit të adresave, për identifikimin e çdo ndërtese dhe trualli të lirë, brenda së njëjtës njësi të qeverisjes vendore, në territorin e Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 2

Pas nenit 1 shtohet neni 1/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 1/1

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Adresa” përbëhet nga fjalë, numra dhe shenja ortografike, të renditura sipas një rregulli të caktuar, të cilat tregojnë vendndodhjen e saktë të një ndërtese ose të një trualli të lirë. Ajo formohet nga shkronja të alfabetit shqip dhe shifra arabe.

2. “Bulevard”, “rrugë”, “rrugicë”, “shesh”, “park” janë pjesë të territorit publik, që shërbejnë

si referencë për përshkrimin e vendndodhjes së saktë të një ndërtese dhe të një trualli të lirë, brenda së njëjtës njësi të qeverisjes vendore, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. “Regjistri vendor i adresave” është një dokument shtetëror, ku hidhen, ruhen dhe pasqyrohen, në mënyrë të vazhdueshme, elementet përbërëse të adresës.

4. “Regjistri Kombëtar i Adresave” është dokumenti unik shtetëror, që krijohet nga tërësia e të dhënave të regjistrave vendorë të adresave.”.

Neni 3

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2

1. Elementet e adresës janë: emri i rrethit, në përbërje të të cilit ndodhet bashkia ose komuna ku ndodhet ndërtesa; emri i bashkisë ose i komunës; emri i qytetit ose i fshatit; emri i bulevardit, rrugës, rrugicës, sheshit ose parkut ku ka dalje ndërtesa; numri i ndërtesës, numri i hyrjes, numri i apartamentit; kodi postar, i miratuar nga Këshilli i Ministrave.

2. Ministri i Brendshëm, me urdhër, përcakton modelin e adresës dhe radhën e vendosjes së elementeve të adresës në të.”.

Neni 4

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Emërtimi i bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve bëhet me vendim të këshillit bashkiak ose komunal, nën juridiksionin e të cilave ato ndodhen, ndërsa numërtimi i ndërtesave, hyrjeve dhe apartamenteve bëhet nga seksionet dhe zyrat e urbanistikës në bashki ose komunë, nën juridiksionin e të cilave ato ndodhen.”.

Neni 5

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

1. Çdo njësi e qeverisjes vendore krijon, përditëson dhe administron të dhënat në regjistrin vendor të adresave.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile krijon dhe administron Regjistrin Kombëtar të Adresave.

3. Mënyra e krijimit, administrimit të regjistrave vendorë dhe Regjistrin Kombëtar të Adresave, si dhe rregullat e shfrytëzimit të sistemit e të rrjetit informatik përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”.

Neni 6

Në nenin 14, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Në qoftë se një ndërtesë ka dy ose më shumë hyrje, që dalin në një bulevard, rrugë, rrugicë, shesh ose park, të cilat përdoren për hyrje dhe dalje, secilës hyrje i vihet një numër.”.

Neni 7

Në nenin 21, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Ngarkohet Ministri i Brendshëm të nxjerrë aktet nënligjore për të përcaktuar rregulla të hollësishme për emërtimin dhe numërtimin e ndërtesave dhe të rrugëve, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni.”.

Neni 8

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25

Tabelat për emërtimin e bulevardëve, të rrugëve, rrugicave, shesheve, parqeve dhe numërtimin e ndërtesave, të hyrjeve dhe apartamenteve janë standarde brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5829, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.9952, datë 14.7.2008

PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E HIV/AIDS-IT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Ky ligj vendos rregullat për parandalimin dhe kontrollin në marrjen e masave për HIV/AIDS-in, kujdesin, trajtimin dhe mbështetjen për personat që jetojnë me HIV/AIDS.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet nga/ndaj personat/personave fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, me vendbanim/vendqëndrim ose seli në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “HIV” është bashkimi i shkronjave fillestare të emrit të virusit, që shkakton AIDS-in, sipas terminologjisë anglo-saksone, “Human Immunodeficiency Virus” (Virusi i pamjaftueshmërisë imunitare njerëzore). Përkufizimi shkencor i referohet atij të dhënë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

2. “AIDS” është shkurtimi i shprehjes në anglisht të “Acquired Immune Deficiency Syndrome” (Sindroma e pamjaftueshmërisë imunitare të fituar), e cila është forma më e rëndë e infeksionit nga virusi HIV. Sindroma e pamjaftueshmërisë imunitare të fituar (AIDS) është bashkësia e shenjave dhe çrregullimeve të organizmit, që shfaqet si rezultat i pamjaftueshmërisë së gjendjes mbrojtëse të tij nga veprimi i virusit HIV dhe e ekspozon atë ndaj infeksioneve të tjera.

3. “Infeksione oportuniste” janë infeksionet që shkaktohen nga mikrobe (bakterie, protozore, kërpudha dhe viruse), që shfrytëzojnë gjendjen e dobësuar mbrojtëse të organizmit, në rastin konkret të shkaktoar nga virusi HIV. Nëse nuk do të ekzistonte kjo gjendje e dobësuar mbrojtëse, këto mikrobe nuk do të shkaktonin infeksion.

4. “Stigmatizim” është sjellja e përbuzjes ose e mosrespektimit të një personi, për shkak të qenies ose të dyshimit se është i infektuar me HIV, ose se ka marrëdhënie të ngushta me një person të infektuar apo të dyshuar si të infektuar me HIV.

5. “Diskriminim” është akti i largimit, kundërshtimit, izolimit, keqtrajtimit, turpërimit, paragjykitimit ose kufizimit të të drejtave të një personi tjetër, për shkak të qenies ose të dyshimit se është i infektuar me HIV, ose ka marrëdhënie të ngushta me një person të infektuar apo të dyshuar si të infektuar me HIV.

6. “Sjellje me rrezikshmëri të lartë” janë të gjitha sjelljet e vërtetuara, që favorizojnë transmetimin e virusit HIV.

7. “Ekspozim ndaj HIV-it” është ekspozimi ndaj kontaktit të drejtpërdrejtë me faktorë të mundshëm, të vërtetuar, që favorizojnë transmetimin e virusit HIV.

8. “Mbikëqyrje (survejancë) epidemiologjike e HIV/AIDS-it” është grumbullimi, në mënyrë të rregullt dhe sistematike, i informacionit për treguesit epidemiologjikë të HIV/AIDS-it, për grupet me rrezikshmëri të lartë, për të njohur prirjen në kohë dhe rezultatet për kontrollin dhe parandalimin e HIV/AIDS-it, si dhe për të siguruar informacion për planifikimin, parandalimin, kontrollin dhe zhvillimin e efektshmërisë së masave të marra.

9. “Mbikëqyrje (survejancë sentinel) e HIV/AIDS-it” është grumbullimi i informacionit, nëpërmjet testeve të rregullta dhe sistematike, për virusin HIV, të grupeve të përzgjedhura për këtë objekt, për të monitoruar ritmet dhe prirjen në kohë të HIV-it, si dhe për të siguruar informacion për planifikimin, parandalimin, kontrollin dhe zhvillimin e efektshmërisë së masave të marra.

10. “Këshillim për HIV/AIDS-in” është bashkëbisedimi në mirëbesim ndërmjet një personi dhe një këshilluesi, i cili synon të përgatisë personin të përballojë pasojat e stresit të mundshëm dhe të marrë vendime, bazuar në informacione për HIV/AIDS-in. Kjo përfshin informimin, edukimin dhe mbështetjen psiko-sociale, të cilat i mundësojnë personit të jetojë me HIV-AIDS dhe të mos përhapë më tej infeksionin.

11. “Testim për HIV-in” është diagnoza laboratorike, që kryhet në mostrat e gjakut ose të lëngjeve të tjera biologjike të një personi, nëpërmjet të cilave vërtetohet statusi i tij lidhur me infeksionin HIV.

12. “HIV pozitiv” është rezultati i testimit të gjakut apo i lëngjeve të tjera biologjike, ku është zbuluar prania e virusit apo e antitropave anti-HIV, nëpërmjet të cilit vërtetohet se personi është i infektuar me HIV.

13. “Grup edukativ shoqëror” është një grup i caktuar njerëzish, me karakteristika të përbashkëta, si mosha, gjinia, niveli arsimor etj. që, me punë informuese dhe edukuese, sjell ndryshime në njohuritë, qëndrimet, besimin, sjelljen ndërmjet vetë anëtarëve të grupit.

14. “Grup i lëvizshëm” është grupi i popullsisë që, rregullisht, jeton larg nga familja dhe që ndryshon vendin e banimit dhe të punësimit.

15. “Masa ndërhyrëse për pakësimin e dëmit për parandalimin e transmetimit të HIV-it” janë informimi, nxitja e përdorimit të mbrojtësve, gjilpërave dhe shiringave njëpërdorimshe nga përdoruesit e drogave me injektim, trajtimi me terapi zëvendësuese pas drogimit dhe të tjera masa ndërhyrëse për reduktimin e dëmit, për parandalimin e transmetimit të HIV-it.

16. “Masa të parandalimit universal” është tërësia e procedurave dhe e rregullave, për parandalimin e infeksioneve, me origjinë nga gjaku dhe lëngjet biologjike.

17. “Ndihmë shoqërore” është ndihma në shërbime ose në të holla, që i jepet një personi me HIV/AIDS.

18. “Trajtim specifik” përfshin ato barna, që shërbejnë për trajtimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

Neni 4

Parimet e parandalimit dhe të kontrollit të HIV/AIDS-it

Parimet e parandalimit dhe të kontrollit të HIV/AIDS-it janë:

1. Ndërthurja e masave financiare, psiko-sociale, teknike, mjekësore dhe shkencore për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it, përmes informimit, edukimit dhe komunikimit për ndryshimin e sjelljes së individëve.

2. Bashkëpunimi ndërsektorial dhe përfshirja e shoqërisë në parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it në programet e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik.

3. Ndërthurja e masave për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it me masat për parandalimin dhe kontrollin e abuzimit me drogat dhe punonjësit e seksit, kontrollin e infeksioneve spitalore dhe atyre të transmetuara nëpërmjet gjakut dhe lëngjeve biologjike për reduktimin e dëmit.

4. Reduktimi i stigmës dhe i diskriminimit të personave të infektuar me HIV dhe të anëtarëve të familjeve të tyre, krijimi i lehtësive për personat e infektuar me HIV dhe familjet, me synim përfshirjen e tyre në jetën shoqërore.

Neni 5

Politikat shtetërore për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it

Politikat shtetërore për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it përfshijnë:

1. Nxitjen e organizatave dhe të individëve të bashkëpunojnë dhe të mbështesin, me të gjitha format, parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

2. Nxitjen e subjekteve publike ose private për të trajnuar dhe punësuar personat e infektuar me HIV dhe anëtarët e familjeve të tyre, si dhe për të investuar për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

3. Bashkërendimin e burimeve për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it, në përshtatje me kushtet kombëtare ekonomiko-shoqërore dhe situatën epidemike të HIV/AIDS-it në çdo periudhë.

4. Mbështetjen e kërkimeve shkencore, si dhe transferimin e teknologjive, për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

5. Mbështetjen për parandalimin dhe kontrollin e transmetimit nga nëna te fëmija dhe mbështetjen e personave që jetojnë me HIV/AIDS.

6. Marrjen e masave të gjithanshme për të garantuar gjak të sigurt.

Neni 6

Menaxhimi për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it

1. Ministria e Shëndetësisë është institucioni kryesor përgjegjës për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

2. Ministria e Shëndetësisë bashkërendon punën me ministritë dhe institucionet përgjegjëse shtetërore, për kryerjen e menaxhimit shtetëror për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

3. Ministri i Shëndetësisë përcakton, me akte nënligjore, mënyrat e parandalimit, të diagnostikimit dhe trajtimit të infeksionit nga HIV-i, si dhe të kontrollit për HIV-in të lëngjeve biologjike e të indeve, që përdoren për diagnostikim terapeutik ose shkencor.

4. Njësitë e qeverisjes vendore duhet të përfshijnë në veprimtarinë e tyre marrjen e masave dhe shërbimeve për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

Neni 7

Subjektet përgjegjëse për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it

1. Institucionet përgjegjëse shtetërore kanë detyrë hartimin e politikave, zbatimin e ligjit, informimin e vazhdueshëm, si dhe zbatimin e programeve të veprimit, për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

2. Familjet kujdesen për zbatimin e masave për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrimet e personave që jetojnë me HIV/AIDS

1. Personat që jetojnë me HIV/AIDS gëzojnë këto të drejta:

a) kujdesin shëndetësor, barnat për mjekim, ambulator ose spitalor, falas në institucionet shëndetësore publike;

b) arsimimin në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, publik ose privat;

c) punësimin, në përshtatje me kërkesat e vendit të punës;

ç) konfidencialitetin për infektimin e tyre me HIV/AIDS;

d) refuzimin e trajtimit dhe të ekzaminimit mjekësor, kur janë duke marrë trajtim të plotë për AIDS;

dh) integrimin në komunitet dhe shoqëri;

e) transportin falas për në qendrat e trajtimit dhe të kujdesit;

ë) të drejta të tjera, të parashikuara nga ky ligj dhe ligje të tjera në fuqi.

2. Personat që jetojnë me HIV/AIDS kanë këto detyrime:

a) zbatimin e masave për parandalimin dhe transmetimin e HIV-it te persona të tjerë;

b) informimin për rezultatin e testimit HIV pozitiv të bashkëshortit/bashkëshortes ose bashkëjetuesit/bashkëjetueses;

c) detyrime të tjera, të parashikuara nga ky ligj dhe ligje të tjera në fuqi.

Neni 9

Akte të ndaluara

Akte të ndaluara janë:

1. Transmetimi i qëllimshëm ose shkaktimi i transmetimit të virusit HIV te një person tjetër.

2. Kërcënim për transmetim të HIV-it te një person tjetër.

3. Stigmatizimi dhe diskriminimi i një personi që jeton me HIV/AIDS.

4. Braktisja nga prindërit e fëmijës së mitur, të infektuar me HIV; braktisja nga kujdestari ligjor i fëmijës, nën kujdestari, të infektuar me HIV.

5. Bërja publike e emrit, adresës dhe pamjes (imazhit) së personit të infektuar me HIV ose zbulimi i informacionit të një personi të infektuar nga një tjetër, pa miratimin e tij, me përjashtim të rastit të përcaktuar në nenin 29 të këtij ligji.

6. Falsifikimi i raportit të infektimit me HIV nga një person, që nuk është i infektuar.

7. Detyrimi për të kryer testimin e HIV-it, me përjashtim të rasteve të përmendura në nenin 29 të këtij ligji.

8. Refuzimi për t'i dhënë trajtim ose ekzaminim mjekësor një personi, që dihet ose dyshohet se është i infektuar me HIV.

9. Transfuzioni i gjakut apo i produkteve të gjakut të infektuar me HIV, transplantimi i pjesëve të ndryshme të trupit të një personi të infektuar me HIV te një person tjetër, kur mjekët kanë dijeni apo të dhëna të mjaftueshme se dhuruesi i gjakut është i infektuar me HIV.

10. Dhënia e avantazheve për kontrollin dhe parandalimin e HIV/AIDS-it për përfitim personal, ose kryerja e veprimeve të paligjshme.

11. Akte të tjera, të ndaluara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

KREU II

MASAT SHOQËRORE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E HIV/AIDS-IT

SEKSIONI I

INFORMIMI, EDUKIMI DHE KOMUNIKIMI

Neni 10

Qëllimet dhe kërkesat e informimit, të edukimit dhe komunikimit

1. Informimi, edukimi dhe komunikimi për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it kanë për qëllim rritjen e njohurive për ndryshimin e sjelljeve, të qëndrimeve, si edhe për pakësimin e stigmatizimit dhe të diskriminimit për personat që jetojnë me HIV/AIDS.

2. Informimi, edukimi dhe komunikimi për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it duhet të jenë:

- a) të saktë, të qartë, të thjeshtë dhe praktikë;
- b) të përshtatshëm për ata, të cilëve u drejtohet, për shkallën e tyre të edukimit, moshën, gjininë dhe traditat, kulturën, identitetin etnik, fenë, besimet dhe zakonet;
- c) jodiskriminues dhe pa keqpërdorur informacionet ose pamjet e personave që jetojnë me HIV/AIDS.

Neni 11

Përmbajtja e informimit, edukimit dhe komunikimit për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it

Informimi, edukimi dhe komunikimi për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it duhet të përmbajë të dhëna për:

1. Mënyrën e infektimit me HIV, rrugët e transmetimit të HIV-it, masat parandaluese e të kujdesit për trajtimin e personave që jetojnë me HIV/AIDS.

2. Ndikimet e HIV/AIDS-in në shëndetin njerëzor dhe zhvillimin e jetës shoqërore-ekonomike të vendit.

3. Të drejtat dhe detyrimet e individëve, të familjeve dhe personave që jetojnë me HIV/AIDS për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

4. Testimin, kujdesin, mbështetjen, mënyrat e trajtimit dhe të shërbimit, të përcaktuara për personat që jetojnë me HIV/AIDS.

5. Përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse shtetërore, të njëjstëve të qeverisjes vendore, organizatave jofitimprurëse ose komuniteteve të ndryshme për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

6. Masat për parandalimin e transmetimit të HIV-it.

7. Reduktimin e stigmatizimit dhe të diskriminimit të personave që jetojnë me HIV/AIDS.

8. Politikat shtetërore dhe ligjet për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

Neni 12

Grupet e interesuara për informimin, edukimin dhe komunikimin, për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it

1. Cilido ka të drejtë të ketë akses për informimin, edukimin dhe komunikimin, për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

2. Grupet e interesuara, që kanë përparësi për informimin, edukimin dhe komunikimin, për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it, janë:

- a) personat që jetojnë me HIV/AIDS dhe anëtarët e familjeve të tyre;
- b) përdoruesit e drogave;
- c) personat, që kanë infeksione seksuale të transmetueshme;
- ç) meshkujt, që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj;
- d) punonjëset e seksit;
- dh) grupet e lëvizshme të popullsisë;
- e) gratë shtatzëna;
- ë) të rinjtë.

Neni 13

Institucionet përgjegjëse për informimin, edukimin dhe komunikimin,

për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it

1. Institucionet shtetërore përgjegjëse e organizatat jofitimprurëse përgatisin dhe e shpërndajnë informacionin, si dhe realizojnë edukimin dhe komunikimin, për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it, në përputhje me pikën 2 të nenit 10 të këtij ligji.

2. Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për bashkëpunimin me palët e përfshira në proces, për të siguruar informacion të saktë dhe shkencor për HIV/AIDS-in.

3. Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për përgatitjen dhe shpërndarjen rregullisht të informacionit në media dhe integrimin e programeve për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it në programe të tjera të informimit dhe të komunikimit.

4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka për detyrë të fusë në sistemin kombëtar të arsimit program mësimor dhe tekste mësimore, për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it, duke e ndërthurur këtë informacion me edukimin seksual dhe atë të shëndetit riprodhues.

5. Institucionet përgjegjëse shtetërore e realizojnë informimin, edukimin dhe komunikimin, për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it në institucionet e shërbimit social, shtetëror, institucionet rezidenciale të përkujdesit social, institucionet e trajtimit mjekësor, institucionet e edukimit dhe të riedukimit, burgjet dhe vendet e paraburgimit.

6. Radiotelevizioni Publik Shqiptar duhet t'u krijojë hapësira dhe përparësi programeve për informimin, edukimin dhe komunikimin, për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

SEKSIONI II

NDËRGJEGJËSIMI I FAMILJES, I ORGANIZATAVE DHE INDIVIDËVE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E HIV/AIDS-IT

Neni 14

Parandalimi dhe kontrolli i HIV/AIDS-it në familje

1. Familjet kujdesen dhe marrin masa për edukimin e anëtarëve të tyre, për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

2. Çiftet, para martesës, apo grua ja shtatzënë, para lindjes së fëmijës, nxiten për kryerjen vullnetarisht të testit të HIV-it.

3. Familjet, që kanë persona që jetojnë me HIV/AIDS, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse shtetërore dhe organizatat që merren me parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it, kujdesen dhe mbështesin këta persona për integrimin e tyre në familje, komunitet dhe shoqëri.

Neni 15

Parandalimi dhe kontrolli i HIV/AIDS-it në vendin e punës

1. Punëdhënësi ka detyrë:

a) të bashkëpunojë për informimin, edukimin dhe komunikimin e vazhdueshëm të punonjësve, me synim parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it, antistigmatizimin dhe antidiskriminimin e personave me HIV/AIDS;

b) të krijojë kushte të favorshme pune për shëndetin dhe kualifikime profesionale për punonjësit që jetojnë me HIV/AIDS;

c) të lehtësojë pjesëmarrjen e punëmarrësve në veprimtaritë për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it;

ç) të zbatojë përgjegjësi të tjera, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

2. Punëdhënësit i ndalohet:

a) të detyrojë punëmarrësin të ndryshojë vendin e punës, apo të kalojë te një punëdhënësi tjetër, për shkak se është me HIV/AIDS;

b) të kundërshtojë rritjen e pagës, ngritjen në detyrë të punëmarrësit ose t'i mohojë të drejtat ligjore, të lidhura me punën, për shkak se është me HIV/AIDS;

c) të kërkojë, në dokumentacionin që shoqëron kërkesën për punësim, rezultatin e testimit të HIV-it, ose të kundërshtojë marrjen në punë të një personi që jeton me HIV/AIDS, përveç rastit të përmendur në pikën 3 të nenit 28 të këtij ligji.

Neni 16

Detyrimi i institucioneve arsimore, publike ose private

1. Në rastet kur nxënësi apo studenti është me HIV/AIDS, institucioneve arsimore, publike ose private, nuk u lejohej:
 - a) të kundërshtojnë pranimin e tij në institucion;
 - b) të marrin masë disiplinore ose ta përjashtojnë atë nga institucioni për shkak të HIV/AIDS-it.
2. Institucionet arsimore, publike ose private, nuk duhet të bëhen pengesë për nxënësin ose studentin, që të kryejë testimin e HIV-it ose të marrë rezultatin e tij.

Neni 17

Parandalimi dhe kontrolli i HIV/AIDS-it në grupet e lëvizshme të popullsisë

1. Njësitë e qeverisjes vendore kanë për detyrë organizimin e informimit të vazhdueshëm, për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it, për grupet e lëvizshme të popullsisë.
2. Personat fizikë dhe juridikë, në bashkëpunim me institucionet vendore shtetërore, të ngarkuara për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it, kanë detyrë të përcjellin informim të vazhdueshëm, si dhe të zbatojnë kufizimin e masave dëmtuese për transmetimin e infeksionit HIV.
3. Institucionet shëndetësore në nivel vendor, në pikat kufitare kanë detyrë të organizojnë në pikat hyrëse, dalje ose në transit, informimin e vazhdueshëm për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

Neni 18

Parandalimi dhe kontrolli i HIV/AIDS-it nga njësitë e qeverisjes vendore

- Njësitë e qeverisjes vendore kanë detyrë:
- a) të organizojnë informim të vazhdueshëm, për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it, si dhe veprimtari edukuese për kujdesin dhe mbështetjen e personave që jetojnë me HIV/AIDS;
 - b) të mbështesin dhe të kujdesen për personat që jetojnë me HIV/AIDS e familjet e tyre, duke lehtësuar integrimin në komunitet dhe shoqëri, nëpërmjet programeve dhe shërbimeve të caktuara.

Neni 19

Parandalimi dhe kontrolli i HIV/AIDS-it në institucionet e arsimit, të riedukimit, institucionet e trajtimit mjekësor, institucionet rezidenciale të përkujdesit social, burgjet dhe vendet e paraburgimit

1. Personat përgjegjës në institucionet e edukimit, të riedukimit, institucionet e trajtimit mjekësor, institucionet rezidenciale të përkujdesit social, në burgjet dhe vendet e paraburgimit kanë detyrë:
 - a) të organizojnë informim të vazhdueshëm për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it;
 - b) të kujdesen, të këshillojnë dhe të trajtojnë personat që jetojnë me HIV/AIDS, të cilët qëndrojnë në këto institucione.
2. Rregullat për parandalimin e transmetimit të HIV-it, në institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe për kujdesin, këshillimin dhe trajtimin e personave që jetojnë me HIV/AIDS në këto institucione përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20

Pjesëmarrja e organizatave jofitimprurëse në parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it

Shteti nxit dhe mbështet organizatat jofitimprurëse, si dhe organizatat e tjera të ndërmarrin

veprimtari humanitare dhe bamirësie për përkujdesjen dhe trajtimin e personave që jetojnë me HIV/AIDS, si dhe çdo lloj veprimtarie tjetër, që ka si qëllim parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

Neni 21

Pjesëmarrja e personave të infektuar me HIV në parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it

1. Personat e infektuar me HIV kanë të drejtë të marrin pjesë në veprimtaritë për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

2. Shteti nxit dhe ndihmon personat e infektuar me HIV të marrin pjesë:

a) në grupe edukimi bashkëmoshatarësh, klube dhe forma të tjera veprimtarish, të organizuara nga personat e infektuar me HIV, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji;

b) në veprimtari informuese për masat që duhen marrë për reduktimin e dëmit dhe parandalimin e HIV/AIDS-it;

c) në veprimtari për përkujdesjen dhe mbështetjen e personave të tjerë të infektuar me HIV;

ç) në formulimin e programeve, të politikave dhe ligjeve për HIV/AIDS-in;

d) në çdo lloj veprimtarie tjetër, që lidhet me parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

SEKSIONI III

MASA TË TJERA SHOQËRORE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E HIV/AIDS-IT

Neni 22

Masat ndërhyrëse për parandalimin e transmetimit të HIV-it

Masat ndërhyrëse për parandalimin e transmetimit të HIV/AIDS-it zbatohen në grupet me sjellje me rrezikshmëri të lartë, nëpërmjet programeve dhe projekteve të përshtatshme me kushtet shoqërore dhe ekonomike.

Neni 23

Këshillimi për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it

1. Cilido ka të drejtë të përfitojë shërbime këshillimi për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

2. Institucionet shëndetësore dhe institucionet shoqërore, publike ose private, kanë për detyrë të sigurojnë këshillimin për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it, në përputhje me rregulloret e Ministrisë së Shëndetësisë.

3. Këshillimi, para dhe pas testimit, për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it, bëhet në përputhje me parashikimet e nenit 27 të këtij ligji.

Neni 24

Kujdesi pas ekspozimit ndaj HIV-it

Në rastin e ekspozimit, profesional dhe joprofesional, personave të ekspozuar ndaj HIV-it u sigurohet këshillim dhe trajtim profilaktik për parandalimin e infektimit me HIV.

KREU III MASAT MJEKËSORE TEKNIKE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E HIV/AIDS-IT

Neni 25

Mbikëqyrja epidemiologjike dhe raportimi i HIV/AIDS-it

1. Mbikëqyrja epidemiologjike e HIV/AIDS-it përfshin testimin HIV dhe mbikëqyrjen e HIV-it për identifikimin e raportit të përhapjes së tij dhe shpërndarjen e infeksionit HIV/AIDS në grupet e popullsisë, monitorimin e prirjeve të HIV-it në kohën e përhapjes së këtij virusi, identifikimin e grupeve, që kanë sjellje me rrezikshmëri të lartë, infektimin me HIV, për të identifikuar ndryshimet në formën e transmetimit të HIV-it dhe për të parashikuar situatat e përhapjes së infeksionit HIV/AIDS.

2. Institucionet shëndetësore që diagnostikojnë, trajtojnë dhe kujdesen për personat që jetojnë me HIV/AIDS, janë të detyruara të raportojnë rastet pranë strukturave të Institutit të Shëndetit Publik.

3. Ministri i Shëndetësisë miraton, me urdhër, rregulloret për procedurat, mënyrat e mbikëqyrjes epidemiologjike HIV dhe ato të raportimit të HIV/AIDS-it.

Neni 26

Mbikëqyrja sentinel e HIV/AIDS-it

1. Institucioni shëndetësor përgjegjës, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes sentinel të HIV/AIDS-it, mund të kryejë teste për HIV-in te grupet, që kanë sjellje me rrezikshmëri të lartë, në përputhje me rregulloret e Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes sentinel të HIV/AIDS-it, testimet për HIV-in bëhen me metodën anonime të testimit HIV.

3. Personeli dhe institucionet, që kryejnë testimin për HIV, janë përgjegjës për mbajtjen sekret të rezultatit të testimit dhe duhet ta përdorin këtë rezultat vetëm për qëllime të mbikëqyrjes epidemiologjike dhe të kërkimeve shkencore për HIV/AIDS-in.

Neni 27

Këshillimi para dhe pas testimit

1. Këshillimi sigurohet si para dhe pas testimit në çdo rast testimi për HIV-in.

2. Institucionet, që kryejnë testimin për HIV-in, janë përgjegjëse për organizimin e këshillimit para dhe pas testimit.

3. Këshillimi para dhe pas testimit kryhet vetëm nga një personel i trajnuar për këtë qëllim, për këshillimin për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

Neni 28

Testimi vullnetar për HIV-in

1. Testimi për HIV-in kryhet në mënyrë vullnetare nga personi që testohet.

2. Testimi vullnetar për HIV-in kryhet falas në institucionet shëndetësore publike.

3. Personi që kërkon, në mënyrë vullnetare, t'i bëhet testimi për HIV-in, duhet të ketë mbushur moshën 18 vjeç dhe të ketë zotësi të plotë për të vepruar.

4. Testimi për HIV-in, për personat nën 18 vjeç ose për personat, të cilëve u është hequr

zotësia për të vepruar, kryhet vetëm pas dhënies së lejes me shkrim nga prindi ose kujdestari ligjor.

Neni 29

Testimi i detyrueshëm për HIV-in

1. Dhuruesit e gjakut, dhuruesit e indeve dhe të organeve për transplant, dhuruesit për inseminim artificial janë të detyruar t'i nënshtrohen testimit për HIV-in. Ky testim është i detyrueshëm edhe për personat, për të cilët kërkohet zyrtarisht, me vendim gjyqësor ose me kërkesë të prokurorit.

2. Ministri i Shëndetësisë miraton rregulloret për testimin e detyrueshëm, në raste të caktuara, për qëllime diagnostikimi dhe trajtimi.

3. Shpenzimet për realizimin e testimit HIV, për rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

Neni 30

Institucionet e testimit për HIV-in, që plotësojnë kushtet për konfirmimin e rasteve me HIV pozitiv

1. Institucionet e licencuara nga Ministria e Shëndetësisë për realizimin e testeve për HIV-in janë përgjegjëse për realizimin dhe konfirmimin e rezultateve për rastet me HIV pozitiv, për të cilat mbajnë përgjegjësi përpara ligjit.

2. Këshilli i Ministrave përcakton kushtet, procedurat dhe rregullat për licencimin e institucioneve përgjegjëse për kryerjen e testimit për HIV-in dhe për konfirmimin e rasteve me HIV pozitiv.

Neni 31

Njoftimi i rezultatit HIV pozitiv të testimit

1. Rezultati HIV pozitiv i testimit u njoftohet vetëm personave të mëposhtëm:

a) personit të testuar;

b) bashkëshortit/bashkëshortes ose bashkëjetuesit/bashkëjetueses së personit të testuar, prindërve apo kujdestarit ligjor të personit të testuar, kur ky i fundit është i mitur ose ka humbur zotësinë për të vepruar;

c) personelit, i cili ka për detyrë të drejtpërdrejtë të merret me këshillimin dhe informimin, për rezultatin HIV pozitiv të testimit, të personave të testuar;

ç) personave, të cilët janë përgjegjës për përkujdesjen dhe trajtimin e personave të infektuar me HIV, në institucionet shëndetësore, përfshirë shefat e klinikave shëndetësore ose shefat e punonjësve në ato institucione, të cilat kanë detyrë të drejtpërdrejtë trajtimin dhe kujdesin e personave të infektuar me HIV;

d) drejtorëve, personelit mjekësor dhe kujdestarëve, të cilët kanë detyrë të drejtpërdrejtë të kujdesin për personat e infektuar me HIV, të cilët mbahen në institucionet e trajtimit mjekësor, institucionet riedukuese, rezidenciale të përkujdesit social, burgjet apo vendet e paraburgimit;

dh) drejtuesve dhe personave të autorizuar të institucioneve të përmendura në pikën 1 të nenit 30 të këtij ligji.

2. Personat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni janë përgjegjës për ruajtjen e sekretit për rezultatin HIV pozitiv të testimit, përveç rasteve të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni.

KREU IV

MASA TË TJERA TEKNIKO-MJEKËSORE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E HIV/AIDS-IT

Neni 32

Transfuzioni i sigurt i gjakut

1. Të gjitha njësitë e gjakut dhe të produkteve të tij nuk duhet ta përdorin gjakun e produktet e tij, të dhuruara për qëllime klinike apo laboratorike, pa iu nënshtuar më parë kontrollit të detyruar për

HIV-in, madje edhe në rastet e urgjencës.

2. Për kontrollin e gjakut dhe të produkteve të tij për HIV-in duhet të përdoren reagjentë të kontrolluar dhe të regjistruar, të lejuar me udhëzim të Ministrit të Shëndetësisë.

3. Ministri i Shëndetësisë miraton rregullore të hollësishme për mënyrat e testimit për HIV-in, plotësimin e rezultateve të testimit, ruajtjen dhe shkatërrimin e kampioneve të gjakut, të njësive të gjakut, produkteve të tij dhe materialeve patologjike të infektuara me HIV.

Neni 33

Detyrimi për masat e parandalimit universal në institucionet shëndetësore

Në institucionet shëndetësore, ku kryhen operacione, procedura kirurgjikale apo injeksione, duhet të zbatohen rregullat për masat e parandalimit universal, për parandalimin e transmetimit të HIV-it.

Neni 34

Parandalimi dhe kontrolli i transmetimit të HIV-it në institucionet e shërbimit social

Institucionet rezidenciale të përkujdesit social, të cilat përdorin injeksione dhe mjete të tjera prerëse dhe shpuese, që rrezikojnë të shkaktojnë gjakrrjedhje te përdoruesit e shërbimit, janë përgjegjëse për zbatimin e rregulloreve të Ministrisë së Shëndetësisë për masat e parandalimit universal.

Neni 35

Parandalimi dhe kontrolli i infeksioneve seksualisht të transmetueshme

1. Parandalimi dhe kontrolli i transmetimit të HIV/AIDS-it bëhet në ndërthurje me parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme.

2. Ministri i Shëndetësisë miraton, me urdhër, rregullore për monitorimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme, ku përcaktohen përgjegjësitë e institucioneve mjekësore për bashkëpunimin në kontrollin për transmetimin e HIV-it në rrugë seksuale.

Neni 36

Parandalimi dhe kontrolli i transmetimit të HIV-it nga nëna te fëmija

1. Institucionet shëndetësore kanë detyrë të ofrojnë këshillim dhe testim për HIV-in, për gratë shtatzëna, pas marrjes së pëlqimit, bazuar mbi informim.

2. Institucionet shëndetësore janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e transmetimit të infeksionit HIV nga nëna te fëmija.

3. Gratë shtatzëna me HIV kanë përparësi në marrjen e informacionit për parandalimin e transmetimit të këtij virusi nga nëna te fëmija.

KREU V

TRAJTIMI, PËRKUJDESJA DHE MBËSHTETJA PËR PERSONAT QË JETOJNË ME HIV/AIDS

Neni 37

Përgjegjësia për sigurimin e trajtimit për personat që jetojnë me HIV/AIDS

1. Institucionet shëndetësore, që kryejnë trajtimin e personave që jetojnë me HIV/AIDS, duhet të plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara në rregulloret e Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe të realizojnë edukimin dhe informimin e këtyre personave, që ata të kujdesen për veten dhe të parandalojnë transmetimin e virusit HIV te personat e tjerë.

2. Institucionet shëndetësore publike kanë për detyrë të sigurojnë ekzaminimet mjekësore specifike për personat që jetojnë me HIV/AIDS.

3. Personat që jetojnë me HIV/AIDS, të cilët kanë infeksione oportune ose infeksione të tjera,

që kanë lidhje me HIV/AIDS-in, duhet të marrin trajtim në institucionet shëndetësore të specializuara për këto infeksione.

4. Ministri i Shëndetësisë nxjerr udhëzime për trajtimin specifik të këtyre personave.

Neni 38

Akresi në trajtimin specifik

1. Shteti garanton trajtimin specifik falas për personat e infektuar me HIV/AIDS.
2. Këshilli i Ministrave vendos për mënyrën e menaxhimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të medikamenteve specifike për HIV/AIDS dhe, në raste emergjence, siguron zbatimin e masave të nevojshme për t'iu përgjigjur kërkesave për këto medikamente.

Neni 39

Dëmshpërblimi në rast infektimi me HIV

Institucionet shëndetësore dëmshpërblejnë personin e infektuar me HIV, sipas legjislacionit në fuqi, në rastet kur ky infektim është pasojë e dhënies së shërbimit shëndetësor ose e zbatimit të procedurave mjekësore.

Neni 40

Ndihma shoqërore për personat që jetojnë me HIV/AIDS

1. Personat nën 18 vjeç, të infektuar me HIV/AIDS, përfitojnë ndihmë shoqërore në të holla ose shërbime, kur ata nuk janë të punësuar.
2. Lloji dhe masa e ndihmës shoqërore, si dhe kriteret e procedurat për shpërndarjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 41

Kujdesi për personat e infektuar me HIV/AIDS

1. Personat e infektuar me HIV/AIDS duhet të merren në përkujdesje nga familjet e tyre dhe nga institucionet shëndetësore dhe sociale shtetërore.
2. Fëmijët e infektuar me HIV/AIDS, të cilët janë të braktisur dhe ata që kanë humbur lidhjet me familjet e tyre ose aftësinë për të punuar, merren në përkujdesje nga institucionet e shërbimeve sociale shtetërore (institucionet rezidenciale të përkujdesjes sociale) ose private.
3. Organizatat jofitimprurëse apo të çdo lloji tjetër mund të ngrenë institucione rezidenciale për përkujdesje ndaj personave që jetojnë me HIV/AIDS.

KREU VI

KUSHTET PËR GARANTIMIN E ZBATIMIT TË PARANDALIMIT DHE KONTROLLIT TË HIV/AIDS-IT

Neni 42

Burimet financiare për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it

Ministria e Shëndetësisë, në buxhetin vjetor, planifikon një fond të veçantë për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

Neni 43

Trajnimi i personave të angazhuar në parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it

1. Personeli që siguron drejtpërdrejt këshillimin, që kryen testimin e HIV-it, ose që siguron kujdesin dhe trajtimin e personave të infektuar me HIV përfiton trajnim.

2. Bashkëpunëtorëve, vullnetarëve, psikologëve në shkolla, mësuesve, personave të infektuar me HIV dhe familjeve të tyre, që marrin pjesë në parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it, u sigurohet trajnim, për të përmirësuar aftësitë.

3. Ministri i Shëndetësisë përgjigjet për bashkërendimin e punës me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrinë e Drejtësisë dhe agjenci të tjera të fushës, për organizimin e trajnimeve të personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni.

Neni 44

Bashkëpunimi ndërkombëtar për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it

1. Shtetasit shqiptarë dhe organizatat nxiten për të bashkëpunuar me organizatat vendase dhe të huaja dhe me individë për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

2. Ministria e Shëndetësisë siguron bashkërendimin e punës ndërmjet ministrive, administratës vendore dhe agjencive simotra të shteteve në kufi me Shqipërinë, për parandalimin dhe kontrollin e transmetimit ndërkufitar të HIV/AIDS-it.

Neni 45

Sanksionet

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e neneve 9, 15 pika 2, 16 pika 2 e 26 pika 3 të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga pesëfishi deri në dhjetëfishin e pagës minimale në shkallë vendi.

2. Autoriteti përgjegjës për vënien dhe ekzekutimin e gjobës është Ministria e Shëndetësisë.

3. Procedurat për vënien e gjobës dhe ankimimin rregullohen me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar.

Neni 46

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 19 pika 2, 30 pika 2, 38 pika 2 dhe 40 pika 2.

2. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet normative në zbatim të neneve 6 pika 3, 25 pika 3, 29 pika 2, 32 pika 3, 35 pika 2 e 37 pika 3.

Neni 47

Shfuqizime

Ligji nr.8689, datë 16.11.2000 “Për parandalimin e përhapjes së infeksionit HIV/AIDS në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të gjitha aktet nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 48

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5830, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ

Nr.9953, datë 14.7.2008

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8116, DATË 29.3.1996
“KODI I PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 shkronja “d” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

Neni 1

Në nenin 510, në fund të shkronjës “d” shtohet togfjalëshi “ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5831, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**LIGJ
Nr.9954, datë 17.7.2008**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR
PROJEKTIN E RRUGËVE DYTËSORE DHE VENDORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e rrugëve dytësore dhe vendore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5832, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE FINANCIMI
(PROJEKTI I RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE) NDËRMJET SHQIPËRISË DHE
SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

Marrëveshja e datës _____, 200_, e lidhur ndërmjet Shqipërisë (Marrësi) dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (Shoqata). Me anë të kësaj, Marrësi dhe Shoqata bien dakord sa më poshtë:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme, përkufizime

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç përkufizohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) përbëjnë pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u jepen atyre në kushtet e përgjithshme.

Neni 2

Financimi

2.01 Shoqata bie dakord t'i japë Marrësit në bazë të termave dhe kushteve të parashtruara ose të referuara në këtë Marrëveshje, një kredi në një shumë të barasvlefshme me dymbëdhjetë milionë e dyqind mijë, të drejta speciale tërheqjeje (SDR 12 200 000) (Kredia) për të asistuar në financimin e projektit të përshkruar në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti).

2.02 Marrësi mund t'i tërheqë të ardhurat e kredisë në përputhje me seksionin IV të aneksit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Norma e tarifës maksimale të angazhimit e pagueshme nga Marrësi për bilancin e kredisë së patërhequr do të jetë një e dyta e një për qind ($\frac{1}{2}$ e 1 %) në vit.

2.04 Tarifa e shërbimit e pagueshme nga Marrësi mbi bilancin e kredisë së tërhequr do të jetë e barabartë me tre të katërtat e një për qind ($\frac{3}{4}$ e 1 %) në vit.

2.05 Datat e pagesës janë 15 prilli dhe 15 tetori të çdo viti.

2.06 Shuma e principalit të kredisë do të shlyhet në përputhje me programin e shlyerjes të parashtruar në aneksin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2.07 Monedha e pagesës është euro.

Neni 3

Projekti

3.01 Marrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të projektit. Për këtë qëllim, Marrësi do të bëjë që projekti të kryhet nga njësia zbatuese e projektit në përputhje me dispozitat e nenit 4 të kushteve të përgjithshme dhe marrëveshjes së projektit.

3.02 Pa u kufizuar në dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje dhe përveç rasteve kur Marrësi dhe Shoqata do të bien dakord ndryshe, Marrësi do të garantojë që projekti të përmbushet në përputhje me dispozitat e aneksit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4
Instrumentet e shoqatës

4.01 Rasti shtesë për pezullim përbëhet sa më poshtë, pra legjislacioni i njësisë zbatuese të projektit është amenduar, pezulluar, shfuqizuar, anuluar ose hequr dorë, që cenon materialisht dhe në mënyrë të pafavorshme aftësinë e njësisë zbatuese të projektit për të përmbushur detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së projektit.

4.02. Afati i bashkëfinancimit për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së bashkëfinancimit është 31 dhjetori 2008.

4.03. Rasti shtesë për përshpejtim përbëhet sa më poshtë, pra që ndodh rasti i specifikuar në seksionin 4.01 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5
Hyrja në fuqi, përfundimi

5.01 Kushti shtesë i hyrjes në fuqi përbëhet sa më poshtë, pra që marrëveshja ndihmëse është ekzekutuar ndërmjet marrësit dhe njësisë zbatuese të projektit.

5.02 Çështja shtesë ligjore përbëhet sa më poshtë, pra që marrëveshja ndihmëse është autorizuar rregullisht nga Marrësi dhe njësia zbatuese e projektit dhe është ligjërisht detyruese për Marrësin dhe njësinë zbatuese të projektit në përputhje me kushtet e saj.

5.03 Afati i hyrjes në fuqi është nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

5.04 Për qëllime të seksionit 8.05 (b) të kushteve të përgjithshme, data në të cilën do të përfundojnë detyrimet e Marrësit sipas kësaj Marrëveshjeje (me përjashtim të atyre që parashikojnë detyrimet e pagesës), është njëzet vjet pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6
Përfaqësuesit, adresat

6.01 Përfaqësuesi i Marrësit është Ministri i Financave.

6.02 Adresa e Marrësit është:

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.1

Tirana

Albania

Faks: (355)-42-228494

6.03 Adresa e Shoqatës është:

International Development Association

1818 H Street, N. W

Washington, D.C. 20433

United States of America

Kablllo:

Teleks:

Faks

INDEVAS

248423(MCI)

(1)-202-477-6391

Washington D.C

Rënë dakord në _____, _____, në ditën dhe vitin e shkruar më sipër.

SHQIPËRIA

Nga

Përfaqësuesi i autorizuar

SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

Nga

Përfaqësuesi i autorizuar

ANEKSI 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i projektit është të përmirësojë aksesin ndaj shërbimeve kryesore dhe tregjeve ekonomike nëpërmjet sigurimit të rrugëve të përshkueshme gjatë gjithë vitit për popullsinë banuese në pjesët e brendshme të rrugëve të projektit, duke përfshirë: i) përmirësimin e seksioneve prioritare të rrjetit rrugor dytësor (rajonal) përgjatë territorit të Marrësit; ii) përmirësimin e seksioneve prioritare të rrjetit rrugor lokal përgjatë territorit të Marrësit; dhe iii) forcimin e menaxhimit të rrjetit të rrugëve dytësore dhe lokale.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1: Përmirësimi i seksioneve prioritare të rrjetit të rrugëve dytësore (rajonale)

Financimi i nënprojekteve për të rehabilituar dhe rikonstruktuar seksionet e përzgjedhura prioritare të rrjetit të rrugëve dytësore (rajonale), duke përfshirë sigurimin e infrastrukturës së sigurisë rrugore, aty ku është e nevojshme.

Pjesa 2: Përmirësimi i seksioneve prioritare të rrjetit të rrugëve lokale (komunave)

Financimi i nënprojekteve për të rehabilituar dhe rikonstruktuar tërësisht seksionet e përzgjedhura prioritare të rrjetit të rrugëve lokale (komunave), duke përfshirë sigurimin e infrastrukturës së sigurisë rrugore, aty ku është e nevojshme.

Pjesa 3: Zbatimi dhe mbështetja institucionale

Sigurimi i mbështetjes teknike, mallrave (duke përfshirë automjetet, kompjuterët, pajisjet e ajrit të kondicionuar, një gjenerator dhe mobilet e zyrës), trajnimi, ture studimore, konferencat dhe financimi i kostove operacionale për të asistuar njësinë zbatuese të projektit në zbatimin e projektit, specifikisht për: i) përzgjedhjen dhe përdorimin e shërbimeve të konsulentëve për të mbikëqyrur punimet civile dhe për të përmirësuar projektimin për kohëzgjatjen e projektit; ii) përzgjedhjen dhe punësimin e një asistenti teknik me përvojë të konsiderueshme në inxhinierinë e autostradave për kohëzgjatjen e projektit; iii) trajnimin e stafit të njësisë zbatuese të projektit, përgjegjës për zbatimin e projektit; iv) kryerjen e një rishikimi të klasifikimit funksional për të gjitha nivelet e rrugëve; v) një inventar të rrjetit kryesor të rrugëve dytësore dhe lokale; vi) përgatitjen e një strategjie dhe plani veprimi për zhvillimin e rrjetit të rrugëve dytësore dhe lokale; vii) ndërtimin e kapaciteteve në komunitete për të kontraktuar dhe kryer mirëmbajtjen; viii) krijimin e një sistemi menaxhimi asetesh për rrugët dytësore (rajonale) dhe lokale; dhe ix) përgatitjen e dokumenteve të projektit dhe tenderit për vitin e parë dhe të dytë të zbatimit të projektit.

ANEKSI 2 EKZEKUTIMI I PROJEKTIT

Seksioni I. Masat e zbatimit

A. Marrëveshja ndihmëse

1. Për të lehtësuar kryerjen e projektit, Marrësi do të bëjë që të ardhurat e kredisë të alokohen herë pas here për kategoritë (1) dhe (2) në dispozicion të njësisë zbatuese të projektit mbi bazë granti, sipas një marrëveshjeje ndihmëse ndërmjet Marrësit dhe njësisë zbatuese të projektit (“Marrëveshja ndihmëse”).

2. Marrësi do të ushtrojë të drejtat e tij sipas marrëveshjes ndihmëse në mënyrë që të mbrojë interesat e Marrësit dhe Shoqatës dhe të përmbushë qëllimet e kredisë. Përveç rasteve kur Shoqata bie dakord ndryshe, Marrësi nuk do të transferojë, amendojë, shfuqizojë ose heqë dorë nga marrëveshja ndihmëse ose ndonjë prej dispozitave të saj.

B. Antikorrupsioni

Marrësi do të garantojë që projekti të përmbushet në përputhje me dispozitat e udhëzimeve

antikorruption.

C. Nënprojektet

1. Kriteret për përzgjedhjen e rrugëve

Me qëllim rritjen e përfitimeve që duhet të nxirren nga projekti, Marrësi do të marrë të gjitha masat e nevojshme në emër të tij për të siguruar ndjekjen e procedurave të mëposhtme në fazat paraprake të përzgjedhjes së nënprojekteve të propozuara për rehabilitimin dhe/ose ndërtimin sipas pjesëve 1 dhe 2 të projektit:

a) NJQV-të do të identifikojnë nënprojektet e mundshme për dorëzim mbi bazën e kriterëve të mëposhtme: i) rruga duhet të ketë potencial të konsiderueshëm zhvillimi (potencial bujqësor, prodhim, turizëm); ii) rruga duhet të ketë përdorim aktual të rëndësishëm ose me mundësi të tillë; iii) ekzistenca e një numri të konsiderueshëm përfituesish (popullsia, varfëria); dhe iv) nuk duhet të ketë asnjë ndikim negativ të konsiderueshëm mbi mjedisin ose popullsinë që banon në pjesën e brendshme të rrugës; dhe

b) Nënprojektet e identifikuar në këtë mënyrë do të jenë ato me prioritet më të lartë që duhet t'i paraqiten njësisë zbatuese të projektit për prioritizim dhe përzgjedhje të mëtejshme.

2. Pranueshmëria e mëtejshme për rrugët që ndodhen në disa zona gjeografike

Marrësi do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se asnjë propozim nënprojekti ka lidhje me, dhe asnjë e ardhur e kredisë nuk do përdoret për të financuar, një nënprojekt të ndodhur:

a) në zonën e mbuluar nga plani i zhvillimit jugor detar, derisa dhe vetëm nëse ky plan është miratuar formalisht nga Këshilli i Rregullimit të Territorit; dhe

b) në zonën bregdetare në pjesën që mbetet të bregdetit shqiptar, derisa dhe vetëm nëse është miratuar një plan zhvillimi ose është paraqitur për miratim pranë Këshillit të Rregullimit të Territorit.

D. Administrimi dhe menaxhimi i rrugëve dytësore rajonale

Marrësi, nëpërmjet Ministrisë së tij të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, do të përgatisë një draft vendim të Këshillit të Ministrave, të pranueshëm për Shoqatën, që do të kalohet jo më vonë se data 31 dhjetor 2008, duke i transferuar të drejtat për administrim dhe menaxhim të të gjitha rrugëve rajonale dytësore nga këshillat rajonale në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve.

E. Sigurimi i fondeve dhe burimeve të tjera

Pa u kufizuar në dispozitat e seksionit 4.03 të kushteve të përgjithshme, Marrësi do të marrë të gjitha masat e nevojshme në emër të tij për të garantuar se:

a) ekipi përgjegjës për zbatimin e projektit brenda njësisë zbatuese të projektit është plotësuar me personel të mjaftueshëm dhe është siguruar me burime financiare, njerëzore dhe teknike të mjaftueshme dhe në kohë, gjatë kohëzgjatjes së projektit; dhe

b) duke filluar nga viti fiskal 2009 dhe deri në vitin fiskal 2013, fonde të mjaftueshme alokohen në buxhetin e tij vjetor për të mbuluar kontributin e tij financiar për financimin e projektit.

Seksioni II. Monitorimi dhe vlerësimi i projektit

A. Raporti përfundimtar

Për qëllime të seksionit 4.08 (c) të kushteve të përgjithshme, raporti mbi ekzekutimin e projektit dhe planin që kërkohet sipas atij seksioni do të jepet nga Marrësi për Shoqatën jo më vonë se 30 qershori 2013.

B. Menaxhimi financiar, raportet dhe kontrollet financiare

1. Marrësi do të ruajë ose do të bëjë që të ruhet një sistem menaxhimi financiar në përputhje me dispozitat e seksionit 4.09 të kushteve të përgjithshme.

2. Pa u kufizuar në dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, Marrësi do të përgatisë dhe do t'i japë Shoqatës si pjesë të raportit të projektit jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas fundit të secilit tremujor kalendarik, raporte të përkohshme financiare të paaudituar për projektin që mbulojnë tremujorin, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Shoqatën.

3. Marrësi do t'i auditojë pasqyrat e tij financiare në përputhje me dispozitat e seksionit 4.09 (b) të kushteve të përgjithshme. Secili audit i pasqyrave financiare do të mbulojë periudhën e një viti fiskal të Marrësit, duke filluar me vitin fiskal në të cilin është bërë tërheqja e parë sipas paradhënies për përgatitjen e projektit. Pasqyrat e audituara financiare për secilën periudhë të tillë do t'i jepen Shoqatës jo më vonë se gjashtë muaj pas mbarimit të kësaj periudhe.

Seksioni III. Prokurimi

A. Të përgjithshme

1. Mallrat, punimet dhe shërbimet (me përjashtim të shërbimeve të konsulentëve). Të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet (me përjashtim të shërbimeve të konsulentëve) të kërkuara për projektin dhe që duhet të financohen nga të ardhurat e kredisë do të prokurohen në përputhje me kërkesat e parashtruara ose të referuara në seksionin I të udhëzuesve të prokurimit dhe me dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulentëve të kërkuara për projektin dhe që duhet të financohen nga të ardhurat e kredisë do të prokurohen në përputhje me kërkesat e parashtruara ose të referuara në seksionet I dhe IV të udhëzuesve të konsulentëve dhe dispozitat e këtij seksioni.

3. Përkufizimet. Termat me germa kapitale të përdorura më poshtë në këtë seksion për të përshkruar metoda të veçanta prokurimi ose metoda rishikimi nga Shoqata për kontrata të veçanta, i referohen metodës korresponduese të përshkruar në udhëzuesit e prokurimit ose udhëzuesit e konsulentëve, sipas rastit.

B. Metoda të veçanta të prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve (me përjashtim të shërbimeve të konsulentëve)

1. Tender me konkurrim ndërkombëtar. Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat dhe punimet do të prokurohen sipas kontratave të lidhura mbi bazën e tenderit me konkurrim ndërkombëtar.

2. Metoda të tjera të prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve (me përjashtim të shërbimeve të konsulentëve). Tabela e mëposhtme specifikon metodat e prokurimit, me përjashtim të tenderit me konkurrim ndërkombëtar që mund të përdoren për mallrat, punimet dhe shërbimet (me përjashtim të shërbimeve të konsulentëve). Plani i prokurimit do të specifikojë rrethanat sipas të cilave mund të përdoren këto metoda:

Metoda e prokurimit
a) Tender me konkurrim kombëtar, subjekt i ndryshimeve dhe shtesave të parashtruara në paragrafin 3 më poshtë
b) Blerja
c) Kontraktimi i drejtpërdrejtë

3. Procedurat e tenderit me konkurrim kombëtar do të bazohen në procedurat e tenderimit të hapur siç përcaktohen në ligjin shqiptar të prokurimit publik dhe dispozitat e mëposhtme shtesë:

i) Procedurat e “Tenderimit të hapur” siç përkufizohen në ligjin shqiptar të prokurimit, do të zbatohen për të gjitha kontratat;

ii) Ofertuesit e huaj nuk do të përjashtohen nga ofertimi dhe asnjë preferencë e asnjë lloji nuk do t'u jepet ofertuesve kombëtarë në procesin e tenderimit. Ndërmarrjet nën pronësinë shtetërore në Shqipëri do të lejohen të ofertojnë vetëm nëse janë ligjërish dhe financiarisht autonome dhe operojnë sipas ligjit tregtar të Marrësit;

iii) Njësitë prokuruese do të përdorin dokumentet model të tenderit të miratuara nga Shoqata;

iv) Në rast të çmimeve më të larta të ofertave në krahasim me vlerësimin formal, të gjitha ofertat nuk do të refuzohen pa miratimin paraprak të Shoqatës;

v) Për paraqitjen e ofertave do të përdoret procedura me një zarf të vetëm;

vi) Paskualifikimi do të kryhet vetëm për ofertuesin e vlerësuar me çmimin më të ulët; asnjë ofertë nuk do të hidhet poshtë në kohën e hapjes së ofertës për arsye kualifikimi;

vii) Ofertuesit që kontraktajnë si një ndërmarrje e përbashkët do të jenë përgjegjës kolektivisht dhe individualisht;

viii) Kontratat do të lidhen me ofertuesin e vlerësuar me çmimin më të ulët, kryesisht të

përgjegjshëm, i cili është përcaktuar se është i kualifikuar për të kryer punën në përputhje me kriteret e paracaktuara dhe paraprakisht të publikuara të vlerësimit;

ix) Nuk do të lejohen negociata pas-tenderimit me ofertuesin e vlerësuar me çmimin më të ulët ose me ndonjë ofertues tjetër; dhe

x) Kontratat me kohëzgjatje të gjatë (më shumë se 18 muaj) do të përmbajnë dispozita të përshtatjes së duhur të çmimeve.

C. Metoda të veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve

1. Përzgjedhja mbi bazën e cilësisë dhe koston. Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulentëve do të prokurohen sipas kontratave të lidhura mbi bazën e përzgjedhjes në bazë të cilësisë dhe koston.

2. Metoda të tjera të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve. Tabela e mëposhtme specifikon metoda të prokurimit me përjashtim të përzgjedhjes mbi bazën e cilësisë dhe koston që mund të përdoren për shërbimet e konsulentëve. Plani i prokurimit do të specifikojë rrethanat sipas të cilave mund të përdoren këto metoda.

Metoda e prokurimit
a) Përzgjedhja e bazuar në kualifikimet e konsulentëve
b) Përzgjedhja sipas një buxheti fiks
c) Përzgjedhja e koston më të ulët
d) Përzgjedhja e burimit të vetëm
e) Përzgjedhja e konsulentëve individualë

D. Rishikimi nga Shoqata i vendimeve të prokurimit

Plani i prokurimit do të parashtojë ato kontrata që do t'i nënshtrohen rishikimit paraprak të Shoqatës. Të gjitha kontratat e tjera do t'i nënshtrohen pas rishikimit nga Shoqata.

Seksioni IV. Tërheqja e të ardhurave të kredisë

A. Të përgjithshme

1. Marrësi mund të tërheqë të ardhurat e kredisë në përputhje me dispozitat e nenit 2 të kushteve të përgjithshme, të këtij seksioni dhe udhëzimeve të mëtejshme të tilla, siç do të specifikojë Shoqata me njoftim ndaj Marrësit (duke përfshirë “Udhëzimet e disbursimit të Bankës Botërore për projektet” të datës maj 2006, siç rishikohen herë pas here nga Shoqata dhe siç bëhen të zbatueshme për këtë Marrëveshje sipas këtyre udhëzimeve) për të financuar shpenzimet e lejueshme siç parashtrihen në tabelën në paragrafin 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e shpenzimeve të lejueshme që mund të financohen nga të ardhurat e kredisë (Kategoria), alokimet e shumave të kredisë për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që duhet të financohen për shpenzimet e lejueshme në secilën kategori:

Kategoria	Shuma e alokuar e kredisë (e shprehur në SDR)	Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen
1. Mallrat, shërbimet e konsulentëve, trajnimet, turet studimore, konferencat dhe kostot operacionale	6 600 000	80%
2. Punimet	5 000 000	80%
3. Rifinancimi i paradhënies për përgatitjen e projektit	600 000	Shumë e pagueshme sipas seksionit 2.07 të kushteve të përgjithshme
SHUMA TOTALE	12 200 000	

3. Për këtë qëllim të këtij paragrafi, termi “Kosto operacionale” nënkupton shpenzimet e bëra për të financuar koston sipas pjesës 3 të projektit për: i) pagat e stafit të njësisë zbatuese të projektit dhe kontributet shtetërore mbi to; ii) dietat dhe shpenzimet e udhëtimit të stafit të njësisë zbatuese të projektit për të përmbushur përgjegjësitë sipas projektit; iii) lëndët djegëse dhe mirëmbajtja për automjetet, sigurimi dhe marrja me qira e tyre; iv) teknologjia e komunikimit (duke përfshirë pa kufizim internetin, telefonin); v) sigurinë, mirëmbajtjen dhe qiranë e ndërtesës; vi) kancelaritë dhe publikimet; dhe vii) komisionet bankare, tarifat e ndryshme dhe shërbimet noteriale.

B. Kushtet e tërheqjes, periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht dispozitave të pjesës A të këtij seksioni, nuk do të bëhet asnjë tërheqje:

a) për pagesat e bëra para datës së kësaj Marrëveshjeje, përveç tërheqjeve, deri në një shumë totale që nuk duhet të tejkalojë 2 400 000 SDR të barasvlefshme, që mund të bëhen për pagesat e bëra para kësaj date, por më ose pas datës 1 mars 2008 për shpenzimet e lejueshme sipas kategorisë (1); ose

b) në kategorinë (2) derisa dhe nëse njësia zbatuese e projektit nuk i ka paraqitur Shoqatës një vërtetim me shkrim për nënprojektin në lidhje me të cilin kërkohet tërheqja që: i) nënprojekti nuk kërkon paraqitjen, përgatitjen dhe publikimin e një VNM, PMM ose PVR specifike, sipas rastit; ose ii) nënprojekti kërkon paraqitjen, përgatitjen dhe publikimin e një VNM, PMM ose PVR specifik, sipas rastit, dhe këto kërkesa janë plotësuar sipas pëlqimit të Shoqatës.

2. Data e mbylljes është 31 dhjetor 2012.

ANEKSI 3
PROGRAMI I SHLYERJES

Data e pagesës përkatëse	Shuma e principalit të kredisë së shlyeshme (shprehur si përqindje) *
Në çdo 15 prill dhe 15 tetor, Duke filluar më 15 tetor 2018 deri në dhe duke përfshirë 15 prill 2028.	5 %

* Përqindjet përfaqësojnë përqindjen e shumës së principalit të kredisë që duhet të shlyhet, përveç rasteve kur Shoqata mund ta specifikojë ndryshe, sipas seksionit 3.03 (b) të kushteve të përgjithshme.

SHTOJCË
PËRKUFIZIME

1. “Udhëzuesit antikorrupsion” nënkuptojnë “Udhëzuesit mbi parandalimin dhe luftimin e mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huatë IBRD dhe kreditë dhe grantet e IDA-s” të datës 15 tetor 2006.

2. “Sistemi i menaxhimit të aseteve” nënkupton sistemin për përcaktimin e prioritetëve për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të rrugëve dytësore dhe lokale që duhet të krijohet në njësinë zbatuese të projektit me asistencën e paradhënies së përgatitjes së projektit sipas pjesës 3 të projektit.

3. “Modeli i bankës i vendimit ekonomik të rrugëve” nënkupton modelin e zhvilluar nga banka sipas iniciativës së mirëmbajtjes së rrugëve për qëllime të menaxhimit të rrjeteve të rrugëve me trafik të ulët.

4. “Kategori” nënkupton një kategori të parashtruar në tabelën në seksionin IV të aneksit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

5. “Bashkëfinancues” nënkupton fondin OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar, të referuar në paragrafin 10 të shtojcës së kushteve të përgjithshme.

6. “Bashkëfinancim” nënkupton një shumë të barasvlefshme me pesëmbëdhjetë milionë dollarë (15 000 000 \$) që duhet të jepet nga bashkëfinancuesi për të asistuar në financimin e pjesëve 1 dhe 2 të projektit.

7. “Marrëveshja e bashkëfinancimit” nënkupton marrëveshjen që duhet të lidhet ndërmjet Marrësit dhe bashkëfinancuesit që parashikon bashkëfinancimin.

8. “Udhëzuesit e konsulentëve” nënkuptojnë “Udhëzimet: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, publikuar nga banka në maj 2004 dhe rishikuar në tetor 2006.

9. “Vlerësimi i ndikimit mjedisor” ose “VNM” nënkupton një raport që identifikon dhe vlerëson ndikimet e mundshme mjedisore të një nënprojekti të propozuar (siç përkufizohet në vijim), duke vlerësuar alternativa dhe hartuar masat e përshtatshme monitoruese, menaxhuese dhe lehtësuese.

10. “Kudri mbrojtës mjedisor” ose “KMM” nënkupton kudrin mbrojtës mjedisor të miratuar nga Marrësi më 13 mars 2008, duke parashtruar procedurat që duhet të përdoren nga njësia zbatuese e

projektit për përgatitjen dhe miratimin e një nënprojekti (siç përkufizohet në vijim), vlerësimin specifik të ndikimit mjedisor dhe/ose planin e menaxhimit mjedisor (siç përkufizohet në vijim) për çdo segment rrugor ku ekzistojnë çështje mjedisore të një lloji dhe shkalle të mjaftueshme për të nxitur politikatat mbrojtëse të bankës.

11. “Plan menaxhimi mjedisor” ose “PMM” nënkupton një plan menaxhimi mjedisor të një vendi specifik, i përgatitur në përputhje me parametrat e parashtruara në KMM, të pranueshme për Shoqatën, që duhet të zhvillohet nga njësia zbatuese e projektit për secilin nënprojekt të zbatueshëm, duke parashtruar një grup masash institucionale, monitoruese dhe lehtësuese që duhet të merren gjatë zbatimit dhe operimit të nënprojektit për të eliminuar ndikimet e pafavorshme mjedisore dhe sociale, për t’i shmangur ose ulur në nivele të pranueshme dhe duke përfshirë veprimet që nevojiten për zbatimin e këtyre masave.

12. “Vit fiskal” nënkupton periudhën dymbëdhjetë (12) mujore që korrespondon me çdo vit fiskal të Marrësit ose njësisë së zbatimit të projektit (siç përkufizohet në vijim) dhe kjo periudhë fillon më 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor në secilin vit kalendarik.

13. “Kushtet e përgjithshme” nënkuptojnë “Kushtet e përgjithshme të Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar për kreditë dhe grantet”, të datës 1 korrik 2005 (siç është amenduar deri më 15 tetor 2006).

14. “Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve” nënkupton drejtorinë në ngarkim të rrugëve kombëtare nën varësinë e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të Marrësit.

15. “Modeli i menaxhimit dhe zhvillimit të autostradave” nënkupton modelin e zhvilluar nga banka dhe Shoqata e Përhershme Ndërkombëtare e Kongreseve të Rrugëve për qëllime të zhvillimit dhe menaxhimit të rrjetit rrugor.

16. “Marrëveshja e investimit” ose “MI” nënkupton një marrëveshje investimi që duhet të lidhet ndërmjet FSHZH nga njëra anë, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve ose një NJQV, sipas rastit, dhe referuar në paragrafin 5 (b) të seksionit I.C të aneksit të Marrëveshjes së projektit.

17. “Rrjeti i rrugëve lokale” nënkupton rrjetin e rrugëve të komunave në territorin e Marrësit.

18. “LGU” nënkupton një njësi qeverisjeje lokale brenda territorit të Marrësit që përfshin një komunë ose këshill rajonal.

19. “Treguesit e monitorimit dhe vlerësimit” nënkuptojnë treguesit e rënë dakord të monitorimit dhe vlerësimit të parashtruar në një letër të të njëjtës datë, të cilët duhet të përdoren nga njësia zbatuese e projektit për të matur ecurinë në zbatimin e projektit dhe shkallën në të cilën po arrihen objektivat përkatëse.

20. “Marrëveshja e funksionimit dhe menaxhimit” ose “MFM” nënkupton një marrëveshje funksionimi dhe menaxhimi që duhet të lidhet ndërmjet FSHZH dhe një NJQV dhe e referuar në paragrafin 5 (a) të seksionit I. C të Aneksit të Marrëveshjes së projektit.

21. “Udhëzuesit e prokurimit” nënkuptojnë “Udhëzuesit: Prokurimi me huatë e IBRD dhe kreditë IDA” të publikuara nga banka në maj 2004 dhe rishikuara në tetor 2006.

22. “Plani i prokurimit” nënkupton planin e prokurimit të Marrësit për projektin, të datës 9 prill 2008, dhe të referuar në paragrafin 1.16 të udhëzuesve të prokurimit dhe paragrafin 1.24 të udhëzuesve të konsulentit, siç do të përditësohet herë pas here në përputhje me dispozitat e paragrafëve të mësipërm.

23. “Njësia zbatuese e projektit” nënkupton Fondin Shqiptar për Zhvillim ose FSHZH, një fondacion me autonomi administrative, financiare dhe teknike.

24. “Legjislacioni i njësisë zbatuese të projektit” nënkupton kolektivisht, vendimin nr.12 të Këshillit të Ministrave të Marrësit të datës 9 janar 1993, regjistruar më 16 qershor 1993 sipas dispozitave të ligjit të marrësit nr.7512, amenduar me vendimin nr.427 të Këshillit të Ministrave të Marrësit të datës 8 shtator 1994 sipas dispozitave të ligjit të marrësit nr.7695 dhe vendimet e mëposhtme të Këshillit të Ministrave të marrësit: vendimi nr.527 i datës 12 gusht 1996; vendimi nr.324 i datës 22 gusht 1997, vendimi nr.262 i datës 30 prill 1998; vendimi nr.544 i datës 29 korrik 1998; vendimi nr.207 i datës 28 prill 1999; vendimi nr.106 i datës 27 shkurt 2004; vendimi nr.599 i datës 10 shtator 2004 dhe vendimi nr.681 i datës 2 nëntor 2005.

25. “Paradhënia për përgatitjen e projektit” nënkupton paradhënien e referuar në seksionin 2.07 të kushteve të përgjithshme, të dhënë nga Shoqata për Marrësin sipas letërmarrëveshjes nr.P4360-ALB, nënshkruar në emër të Shoqatës më 5 tetor 2007 dhe në emër të Marrësit më 25 tetor 2007.

26. “Këshill rajonal” nënkupton një NJQV të nivelit të dytë që zgjidhet në mënyrë indirekte (përbërë nga kryetarë bashkie dhe kryetarë komunash) dhe që vishet me disa funksione ekskluzive dhe të deleguara.

27. “Risistemimi” nënkupton: i) marrjen e pavullnetshme të tokës (d.m.th. një veprim që mund të merret pa miratimin e dhënë të një personi ose mundësisë së zgjedhjes) duke përfshirë gjithçka që rritet ose që është vendosur në mënyrë të përhershme në atë tokë, si ndërtesat dhe të mbjellat, që rezultojnë në: A) zhvendosjen ose humbjen e strehimit; B) humbjen e aseteve ose të hyrjes në asete; ose C) humbjen e burimeve të të ardhurave ose mjeteve të jetesës, pavarësisht nëse personat e cenuar duhet të lëvizin apo jo në një vend tjetër; ose ii) kufizimin e pavullnetshëm të hyrjes në parqe të caktuara ligjërisht dhe zona të mbrojtura që sjellin ndikime negative në mjetet e jetesës, të personave të cenuar dhe që përfshijnë kufizime në përdorimin e burimeve, të vendosura për njerëzit, që jetojnë jashtë një parku ose zone të mbrojtur, ose për ata që vazhdojnë të banojnë brenda parkut ose zonës së mbrojtur gjatë dhe pas zbatimit të projektit.

28. “Plani i veprimit të risistemimit” ose “PVR” nënkupton një plan veprimi risistemimi për një vend specifik, i përgatitur në përputhje me parametrat e parashtruar në KPT (siç përkufizohet në vijim), i pranueshëm për Shoqatën, që duhet të zhvillohet nga njësi zbatuese e projektit për secilin nënprojekt që përfshin risistemimin duke mbuluar sa më poshtë: i) një regjistrim të përgjithshëm standard dhe informacion vëzhgimi social-ekonomik; norma dhe standarde specifike kompensimi; programe politikash në lidhje me çdo ndikim të mëtejshëm të identifikuar nëpërmjet regjistrimit të përgjithshëm ose vëzhgimit; përshkrimi i vendeve dhe programeve të risistemimit për përmirësimin ose rikuperimin e mjeteve dhe standardeve të jetesës; një program zbatimi për aktivitetet e risistemimit; dhe preventiv të detajuar; ii) masa të hartuara për të garantuar që personat e zhvendosur: A) të informohen rreth opsioneve dhe të drejtave të tyre në lidhje me risistemimin, të konsultohen, t’u ofrohen zgjedhje dhe t’u jepen alternativa risistemimi teknikisht dhe ekonomikisht të mundshme; dhe B) t’u jepet kompensim i menjëhershëm dhe efektiv në koston e plotë të zëvendësimit për humbjet e aseteve që i atribuohen drejtpërdrejt projektit; iii) nëse ndikimet përfshijnë zhvendosjen fizike të personave të zhvendosur: A) u jepet asistencë (si ndihma financiare për zhvendosjen) gjatë zhvendosjes; B) u jepet strehim banese ose vende strehimi ose, siç kërkohet, vende bujqësore për të cilat një kombinim i potencialit prodhues, avantazheve të vendndodhjes dhe faktorë të tjerë është të paktën i barasvlefshëm me avantazhet e vendit të mëparshëm; dhe C) u ofrohet mbështetje pas zhvendosjes për një periudhë të përkohshme, bazuar në një llogaritje të arsyeshme të kohës që ka të ngjarë të nevojitet për të rikuperuar mjetet dhe standardet e tyre të jetesës; iv) procedura ankesash të përballueshme dhe të arritshme, duke marrë parasysh disponueshmërinë e burimeve gjyqësore dhe mekanizmeve komunitarë dhe tradicionalë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve; dhe v) t’u jepet asistencë zhvillimi përveç masave të kompensimit, si përgatitja e tokës, lehtësirat e kredisë, trajnim ose mundësi punësimi.

29. “Kuari i politikës së risistemimit” ose “KPR” nënkupton kuadrin e politikës së transportimit të adoptuar nga Marrësi më 13 mars 2008, i cili parashtron: i) një përshkrim të shkurtër të projektit dhe komponentëve për të cilët kërkohet blerja ose përvetësimi i tokës dhe risistemimit; ii) parimet dhe objektivat që rregullojnë përgatitjen dhe zbatimin e risistemimit; iii) një përshkrim të procesit për përgatitjen dhe miratimin e planeve të veprimit të risistemimit; iv) zhvendosjen e llogaritur të popullsisë dhe kategori të ngjashme të personave të zhvendosur në shkallën e mundshme; v) kriteret e pranueshmërisë për përcaktimin e kategorive të ndryshme të personave të zhvendosur; vi) një kuadër ligjor që rishikon përshtatjen ndërmjet ligjeve dhe rregulloreve të Marrësit dhe kërkesave dhe masave të politikës së Shoqatës, të propozuara për të mbushur çdo hendek ndërmjet tyre; vii) metodat e vlerësimit të aseteve të cenuara; viii) procedura organizative për dhënien e të drejtave, duke përfshirë përgjegjësitë e Marrësit, njësisë së zbatimit të projektit dhe përfituesit; ix) një përshkrim të procesit të zbatimit që lidh zbatimin e risistemimit për punimet civile që duhet të kryhen sipas projektit; x) një përshkrim të mekanizmave rregullues të ankesave; xi) një përshkrim të masave për financimin e risistemimit, duke përfshirë përgatitjen dhe rishikimin e preventivave, qarkullimin e fondeve dhe masat për çështjet e paparashikuara; xii) një përshkrim të mekanizmave për konsultime me dhe pjesëmarrje të personave të zhvendosur në planifikim, zbatim dhe monitorim; dhe xiii) masat

për monitorimin nga njësia e zbatimit të projektit dhe, nëse kërkohet, nga monitorues të pavarur.

30. “Rrjeti i rrugëve dytësore” nënkupton rrjetin e rrugëve rajonale në territorin e Marrësit.

31. “Plani i zhvillimit bregdetar jugor” nënkupton draftplanin e përgatitur nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të Marrësit që parashtrohet kuadrin e zhvillimit për rajonin bregdetar jugor (nga Orikumi në kufirin grek) të territorit të Marrësit.

32. “Nënprojekt” nënkupton një projekt specifik zhvillimi që duhet të kryhet nga njësia zbatuese e projektit duke përdorur të ardhurat e kredisë.

33. “Marrëveshje ndihmëse” nënkupton marrëveshjen e referuar në seksionin I.B të aneksit 2 të kësaj Marrëveshjeje sipas të cilës Marrësi do të vërë në dispozicion të njësisë zbatuese të projektit të ardhurat e kredisë.

34. “Këshilli i Rregullimit të Territorit” nënkupton organin autoritar më të lartë vendimmarrës të Marrësit pranë Këshillit të Ministrave të Marrësit ose çdo pasardhës i tij.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 30.7.2008
Doli nga shtypi më 31.7.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 44 lekë